



NJË MIK ME SHUMË ARMIQ

“Nuk po shkojmë tek axha, sepse do të shikoj serialin”, “Le të mos vijnë, sepse kam punë”, “Nuk shkoj te daja sepse është i asaj partie politike”, “Nuk shkoj te teza, sepse ajo bën haramë”... si dhe shumë “arsye” të tjera do të dëgjosh nga njerëzit, të cilët ranë në kurthet, që iu ngriti shejtani për ta zbehur apo për ta larguar dashurinë, respektin dhe vizitën e farefisit.

Farefisi i gjallë është një kala e fortifikuar pa pasur nevojë ndihmën prej jashtë, farefisi që gëzon afërsi mes vete është miku më dashamirës dhe më i sinqertë i njeriut. Mes tyre do të jetë e pranishme ndihma, këshilla, përkrahja, dashuria e sinqertë, dhembshuria, besimi për njëri-tjetrin, përjetimi i momenteve të mira sikundërse do të përfjethen edhe momente të pakëndshme e ndoshta të rënda për t'i kapërcyer, por me shpejtësi arrihet zbutja e situatës dhe kthehet afrimi sikurse ishte, e shpeshherë edhe më shumë seç ishte, për shkak të rrënjëve, të cilat duan të kthehen afër njëra-tjetrës.

Kjo lidhje aq e fortë sigurisht meriton të kihet zili nga ata që duhet t'i kthejnë njerëzit drejt gjërave më pak apo aspak të rëndësishme. Së këndejmi, ajo lidhje edhe mund të dobësohet nëse faktorët e prishjes janë më aktivë, sesa ato të mirëmbajtjes. Nuk ka dyshim se faktori më i mirë për ruajtjen e kësaj kalaje është vizita e mirëfilltë ndaj farefisit dhe kjo është pika kryesore që sot ka aq shumë armiq. Duke filluar nga mediet, të cilat mundohen të bëjnë një program sa më tërheqës për të gjitha moshat dhe për të dyja gjinitë, angazhimi pas të mirave materiale deri në atë shkallë që e largon njeriun edhe nga anëtarët e familjes dhe jo vetëm nga farefisi, dashuria dhe urrejtja që po bëhet në emër të partive politike, të cilat pa asnjë përjashtim synojnë plotësimin e dëshirave vetjake në rend të parë, keqkuptimi i teksteve fetare ndaj disa dukurive (haramëve); të gjitha këto ndikojnë në shembjen e kësaj fortifikate, ku ne kënaqemi, ngrohemi dhe strehohemi.

Për të ndihmuar sadopak në ruajtjen e kësaj mirësie, që ende është e fortë te populli jonë, në këtë numër vendosëm të theksojmë mësimet fetare që nxisin mirëmbajtjen e kësaj lidhje, duke përmendur tekste të sheriatit, dobitë e kësaj lidhje, rregulla të rëndësishme rreth bojkotit e kështu me radhë.

E lusim Allahun të na ndihmojë t'i jetësojmë porositë islame në shoqërinë tonë, të na japë sinjeritet dhe të na bëjë prej atyre që e flasin të vërtetën dhe punojnë sipas saj. Vërtetë Allahu është Kujdestari ynë dhe Ai ka mundësi të bëjë gjithçka. Amin

Në emër të redaksisë: Omer Berisha

AKTUALE

3-9 | QËNDRIMI I SELEFIJVE TË EGJIPTIT NDAJ

NDRYSHIMEVE TË FUNDIT

10-11 | BLIC LAJME

AKIDE

12-15 | BAZAT E PERCEPTIMIT DHE ARGUMENTIMIT

NË ISLAM

DRITARE

16-19 | ME ALLAHUN E LARTËSUAR

20-22 | LIDHJA FAREFISNORE

23-26 | SHËROHU DUKE VIZITUAR FAREFISIN

FIKH

27-30 | DISPOZITAT E MYSAFIRLLËKUT

FAMILJA

31-33 | LIDHJA E BUKUR E QUAJTUR: "MOTRA NË ISLAM"

34-37 | ËSHTË ÇËSHTJE KOHE

38-40 | MOS NA PARAGJYKONI, PO BISEDONI ME NE!

TEFSIR

41-43 | LIDHJA FAREFISNORE, URË MES FAMILJEVE

HADITH

44-47 | TRI HISE NËNËN E NJË BABANË

THESARE

48-52 | KUSH JAM UNË?

FETVA DHE KONSULTIME

**53-57 | MËSIMET TË RËNDËSISHME RRETH FAREFISNISË
DHE BOJKOTIT**

SHËMBËLLTYRA

58-60 | NJERËZ ME NDIKIM

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Shpërndarje & marketing: Gazmend Zeneli

Boton: AlbIslam

Adresa: rr. Petre Georgiev nr. 63 | Çair | Shkup 1000

e-mail:

albislam@albislam.com

albislam@gmail.com

sms: +389 71 806 114 | fax&tel: +389 2 26 12 932

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOBSMK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784



QËNDRIMI I SELEFIJVE TË EGJIPTIT NDAJ NDRYSHIMEVE TË FUNDIT

Tashmë selefijtë e Egjiptit nuk kritikohen vetëm nga faktorët e jashtëm dhe shërbëtorët e tyre brenda Egjiptit, por edhe nga disa grupime dhe personalitete të njohura, që i përkasin Umetit islam.

SHKRUAN: ISMAIL BARDHOSHI

Vëmendja e gjithë botës, dhe veçanërisht e botës islame që fokusuar në Egjipt gjatë ngjarjeve që sollën atje ndryshimet e fundit. Menjëherë pas rënies së regjimit filluan analizat mbi faktorët që sollën këtë ndryshim, si dhe mbi kontributin dhe qëndrimin e xhemateve, grupimeve, rrymave dhe komuniteteve të ndryshme ndaj tyre. Është afërmendsh që analizat, diskutimet, studimet, deklaratat dhe kritikët që pasojnë ngjarje kaq të mëdha të vihen në shërbim të natyrës dhe formatit, që do të ketë sistemi që pritet të vendoset. Në këtë kuadër xhematet, grupimet dhe faktorët e brendshëm e të jashtëm kanë projektet e tyre, kështu që është krejt e natyrshme të angazhohen për realizimin e tyre. Për të mos përmendur këtu edhe rolin që ka Egjipti si vendi arab më i madh dhe me pozicionin shumë delikat për

ndryshimet që pritet të ndodhin, jo vetën në rangun e botës arabe, por mbase në rang ndërkombëtar. Në qendër të kritikave dhe diskutimeve është qëndrimi i selefijve të atjeshëm, si dhe ndikimi që do të kenë ata në periudhën pas revolucionit. Tashmë selefijtë e Egjiptit nuk kritikohen vetëm nga faktorët e jashtëm dhe shërbëtorët e tyre brenda Egjiptit, por edhe nga disa grupime dhe personalitete të njohura, që i përkasin Umetit islam. Kuptohet që këta të fundit, nga njëra anë kërkojnë të fuqizojnë pozitën e tyre në Umet, dhe nga ana tjetër ky ka qenë dhe vazhdon të jetë përfytyrimi i tyre jo-objektiv për selefijtë. Por në periudhën e pas revolucionit janë treguar kritikë ndaj metodës dhe projektit të selefijve edhe disa njerëz që pretendojnë, se i përkasin këtij menhexhi. Kjo lëkundje mbase vjen nga dija e pakët, por gjithsesi ajo mund të bëhet shkak edhe për pastrimin e rreshtave të thirrjes së

saktë, kështu që - elhamdulillah - nuk ka vend për t'u shqetësuar, se Allahu i bën punët e veta me urtësi. Jam i vetëdijshëm që për t'u dhënë zgjidhje problemeve të Egjiptit ka njerëz më të ditur se unë, por këtu do të përpiqem të jap disa konkluzione, të cilat inshallah u bëjnë dobi muslimanëve kudo që të ndodhen.

Duke qenë se në shumë analiza bëhet krahasimi mes qëndrimit të grupimit të Ihuanul Muslimin dhe qëndrimit të Selefijve ndaj revolucionit të Egjiptit më duhet që të mos e anashkaloj këtë pikë, jo vetëm për të qenë i saktë në pasqyrimin e ngjarjeve, por edhe për faktin se kjo na ndihmon t'i kuptojmë më mirë përfundimet që do të nxjerr.

- Para se të fillonin demonstratat edhe grupimi i vëllezërve muslimanë deklaruan se nuk do të merrnin pjesë në to, por më pas kur doli qartë se këto demonstrata mund të sillnin rënien e regjimit xhemati i vëllezërve muslimanë doli i organizuar në mbështetje të demonstratave, madje ata kanë pjesën e luanit në rrëzimin e regjimit. Ky është një fakt që nuk duhet mohuar. Zoti i bëri ata shkak për rrënimin e regjimit, pasi pa mbështetjen e tyre kjo nuk do të bëhej e mundur. Taktika e përdorur nga ata që shumë e mençur dhe mjaft efikase për rrëzimin e regjimit, sepse ata nuk dilnin dot vetë përballë, por ama regjimi nuk kishte ç'të bënte nëse ata do të dilnin në mbështetje të liberalëve, ish-përkrahësve të regjimit, bijve apo të të privilegjuarve të regjimit, ose njerëzve të Perëndimit. Tashmë dihet që Allahu bëri shkak për rrëzimin Mubarekut njerëzit që ishin rritur dhe formuar nën frymën e regjimit të tij. Pra, Allahu ia solli rrënimin e pushtetit andej nga nuk e mendonte, dhe kjo është mirësi e madhe. Kështu, qëndrimi i ihvanëve si rrallëherë ka qenë i pjekur dhe në përputhje me argumentet dhe synimet e fesë. Shpresoj që ky të jetë një shpërblim nga Zoti

“Ka pasur raste të shumta në histori, kur Allahu ka ndihmuar xhemate të ndryshme të muslimanëve kundër kafirave, edhe pse keto xhemate kanë pasur shtrembërime. Për shembull, Stambollin e çliruan nakshibenditë...”

për mundin dhe sakrificën e tyre të gjatë. Ne nuk duhet t'ia hamë hakun asnjë grupi. Ka pasur raste të shumta në histori, kur Allahu ka ndihmuar xhemate të ndryshme të muslimanëve kundër kafirave, edhe pse keto xhemate kanë pasur shtrembërime. Për shembull, Stambollin e çliruan nakshibenditë. Xhehmitë dhe esharitë kanë pasur sukses në mjaft debate të zhvilluara me ateistët dhe batinitë, gjëra këto që i pohon dhe Ibën Tejmije. Osmanllijtë e mbrojtën botën islame nga rreziku i përhapjes së shiitëve batini safevi. Madje Zoti ndihmon dhe një grup kafirash kundër një tjetri më të keq. Ky është ligj i Zotit. Në këtë kontekst, besimtari mbështet gjithnjë grupin që është më afër të vërtetës. Kështu, ne nuk e mohojmë hairin dhe hakun e këtij xhemati dhe as kontributin e tyre për zgjimin e muslimanëve. Të mos harrojmë se ihvanët kanë dhe përvojë në çështjet e revolucioneve. Ata kanë mbështetur dikur edhe revolucionin që instaloi në Egjipt regjimin e saporrëzuar, dhe ky është fakt. Përveç kësaj, ata janë përqendruar pa marrë parasysh trajtimet e tyre, por realitetin në ndryshimin e gjendjes përmes marrjes së pushtetit, ose përmes ndikimit tek ai. Kërkesa e tyre për shanse të barabarta për t'u përfaqësuar në parlament dhe qeverisje tashmë thuhet u realizuan. Por a do të mbarojnë kërkesat e tyre këtu? Kjo mbetet për t'u parë. Deri tani revolucionin nuk

është shndërruar në fitore të sistemit islam ndaj atij diktatorial, por në fitore të sistemit liberal-demokrat ndaj atij diktatorial. Dhe shpresat janë që ky sistem të krijojë më shumë mundësi për *davet*, me qëllim që të ndryshojë dhe më shumë gjendja e popullit dhe të vendoset sistemi i pastër islam. Mundësitë që të shfrytëzohet liria janë të mëdha. Dhe shpresojmë që zgjimi islam, i cili është gjithnjë në rritje të ecë të paktën me të njëjtin ritëm, ose akoma më mirë, në mënyrë që në një të ardhme të shpejtë të vendoset sistemi i mirëfilltë islam. Por tashmë, si ihvanët dhe selefijtë janë në udhëkryq; nëse mendohet se beteja ka përfunduar me vendosjen e demokracisë dhe hidhen armët, ky është me të vërtetë një devijim shumë i madh. Këtu ihvanët nuk janë shumë të qartë, se çfarë kërkojnë më tej. Nëse ata do të vazhdojnë të mbrojnë sistemin demokratik, kjo do të thotë se ata nuk kërkojnë një sistem të mirëfilltë islam, pra kanë devijime të theksuara në përfytyrimin e atij sistemi. Nga disa artikulime të fundit del, se ata nuk duan shtet fetar, por shtet civil me baza dhe referencë sheriatike. Me sa kuptohet, nënkuptojnë se drejtuesit i zgjedh vetëm populli. Por kjo do të thotë se nëse populli vendos, që në krye të shtetit të vijë një kafir apo një fasik, për ta nuk ka ndonjë pengesë. Kjo ide përbën një devijim shumë të madh, sepse deri më tani në shkrimet e tyre thuhej se pjesëmarrja në parlament apo në qeverisje është thjeshtë një taktikë për ndryshimin e regjimit, por nga artikulimet e fundit shihet se e gjithë beteja e tyre përfundon me vendosjen e sistemit demokratik. Megjithatë me kalimin e kohës do të shihet se çfarë nënkuptojnë. Ne nuk vëmë në dyshim faktin që Ihuanul Muslimin nuk kanë si qëllim që pushteti i ligjëvënies i takon popullit, sepse ky është shirk, dhe ata janë xhemati që e ka dënuar më shumë këtë ide, por ata e përdorin demokracinë me kuptimin që qeveritarët

“Deri tani revolucioni nuk është shndërruar në fitore të sistemit islam ndaj atij diktatorial, por në fitore të sistemit liberal-demokrat ndaj atij diktatorial...”

duhet të zgjidhen nga populli. Në fakt edhe ideja që udhëheqësi të zgjidhet nëpërmjet garës në zgjedhje popullore nuk është e saktë, sepse siç dihet shumë njerëz janë të përdalë (fasika), shumica nuk i peshon mirë gjërat, kështu që kjo mënyrë zgjedhjeje e drejtuesve është e shtrembër që në thelb, dhe prodhon kryesisht shtrembërime, dhe sjell në pushtet njerëzit e këqij, njerëzit e dynjasë, sepse kështu është shumica e njerëzve.

Po qëndrimi i selefijve cili ishte? Para se të tregoj qëndrimin e selefijve duhet të sqaroj disa gjëra. *Davja selefije* bazohet në Kuran dhe Sunet, në përputhje me rrugën e të parëve të Umetit. Si e tillë vetëm kjo është metoda e saktë për thirrjen e njerëzve në fenë e Allahut dhe për rimëkëmbjen e muslimanëve. Por kjo nuk do të thotë, se janë të sakta qëndrimet e çdo selefiu ose çdo aktivisti, hatibi, vaizi apo dijetari, që e shpall veten si selefi. Ndër njerëzit që i vënë më shumë në dukje gabimet e selefijve janë vetë dijetarët e selefijve, si: Albani, Ibën Bazi, Uthejmini etj. Nuk është hera e parë që disa selefij tregojnë apo bëjnë lëvizje të gabuara. Për shembull, në Algjeri disa njerëz që pretendonin se i përkisnin metodës së selefijve patën një përvojë të hidhur, por të njëjtin gabim e bënë edhe Ihvanët në Algjeri. Më herët ihvanët patën një përvojë tjetër të hidhur kur mbështetën revolucionin që solli në pushtet Abdul Naserin. Pra, historia e revolucioneve në botën islame nuk fillon dhe mbase nuk mbaron me revolucionin e fundit

në Egjipt. Atëherë themeli i daves selefije është zbatimi me përpikëri i metodës së pejgamberëve dhe të sahabëve për ndryshimin e gjendjes. Por ka dhe përfytyrime të gabuara të kësaj metode, të cilat kryesisht vijnë nga njerëz, që nuk i përkasin dijetarëve të kësaj thirrje, ose njerëz që kanë botëkuptime nga më të ndryshmet, ose njerëz që nuk kanë dije, pjekuri dhe përvojë. Duke qenë se selefijtë kanë si objektiv përhapjen e besimit të saktë dhe edukimin e muslimanit me ibadet të saktë e sjellje të mirë, ata kanë arritur një sukses të madh në këtë drejtim, një sukses që do ta mohonte veçse një nihilist. Por ku ishte defekti i qëndrimit të disa selefijve të Egjiptit:

A- Mungesa e një përfytyrimi të saktë të rregullave që kanë të bëjnë me mjetet e ndryshimit të gjendjes, arritjes së të drejtave dhe pakësimit të dëmit. Për shembull, është një rregull që thotë kështu: “Mjeti i paligjshëm, në mungesë të një mjeti të ligjshëm, mund të bëhet i ligjshëm, nëse përmes tij realizohet një interes që është më i madh se ndonjë dëm i mundshëm”. Ky rregull është shpjeguar dhe ilustruar edhe me shembuj në librat e dijetarëve të hershëm, që quhen “*kavaid fikhije*”.

Demonstratat nuk janë një mjet i ligjshëm nën hijen e kalifatit Islam, nën hijen e një shteti që zbaton Sheriatin, sepse në sistemin e Sheriatit ka mjete të tjera të ligjshme për arritjen e të drejtave, si: gjykata, këshilla, ndërmjetësimi i mirë, urdhërimi për mirë, ndalimi nga e keqja etj. Por edhe nëse një musliman nuk arrin të fitojë të drejtën e tij nën hijen e një sundimtari që zbaton Sheriatin ai duhet të bëjë durim, sikurse urdhërojnë hadithet. Ai duhet të ndjekë veçse mjetet e ligjshme për arritjen e hakut të tij, dhe assesi të mos shpikë një mjet për të cilin ka ekzistuar nevoja brenda shtetit që formoi Pejgamberi dhe që nuk është marrë parasysh, as nga vetë Pejgamberi lavdërimi dhe paqja e

“Themeli i daves selefije është zbatimi me përpikëri i metodës së pejgamberëve dhe të sahabëve për ndryshimin e gjendjes...”

Allahut qoftë mbi të, as nga shokët e tij. Pra, nëse ka ekzistuar nevoja për një mjet të tillë në shtetin e kalifëve të drejtë, e megjithatë ata nuk e kanë shfrytëzuar si mjet, ai nuk mund të quhet i ligjshëm në kushte të tilla. Pra, sipas kësaj nuk lejohet të importohen mjete nga sistemet e tjera dhe të bëhen pjesë e sistemit islam, përderisa ka qenë nevoja për to në kohën e shtetit të Pejgamberit dhe sahabëve dhe nuk e kanë marrë parasysh, qoftë edhe nëse dikush mendon se e arrin të drejtën veçse me një mjet të tillë, sepse ç’kuptim kanë atëherë argumentet që urdhërojnë për durim ndaj prijësve zullumqarë, që janë në krye të sistemit të mirëfilltë shariatik!!!!... Por duhet të kemi parasysh të gjitha përcaktimet e mësipërme, sepse na nevojiten për konkludimet e mëpasshme. Atëherë, demonstratat nuk futen në ato që quhen “*meslaha mursele (interesa të papërcaktuara)*”, sepse interesat e papërcaktuara, nëse plotësojnë kushtet, bëhen ligj dhe merren parasysh edhe nën hijen e shtetit Islam. Një ndër kushtet e konsiderimit të tyre, siç përmend dhe Ibën Tejmije është që të mos ketë qenë nevoja për to në kohën e Pejgamberit, dhe dihet që ekziston nevoja për mbrojtjen e të drejtave nën hijen e shtetit Islam, por dijetarët nuk i kanë parë të ligjshme. Prandaj konsiderimi i protestave si “*meslaha mursele*” është gabim, madje me këtë kuptim ato hyjnë tek bidatet, siç janë dhe taksat, kryengritja etj. Nën presionin e ndryshimeve që po ndodhin kohët e fundit në disa vende arabe, shumë

njerëz po bëjnë kapërcime të rrezikshme, duke bërë pjesë të sistemit islam edhe mjete të cilat nuk i përkasin atij, madje bien ndesh me mjaft vlera, norma dhe mjete të tij. Në sistemin islam prijësit i jepet *bej'a* (besa për dëgjueshmëri), kështu që nuk ndërrohet me periudha. Prijësi respektohet dhe nderohet, por në përputhje me ligjet e Allahut, ndërsa në sistemet bashkëkohore njerëzit që shahen dhe kundër të cilëve protestohet më shumë janë qeveritarët. Kështu që në sistemet demokratike është shndërruar sharja e qeveritarëve dhe ndërrimi i tyre në një sjellje normale, a thua se kemi të bëjmë me ekipe futbollit. Pra, kemi ndryshim mes sistemit islam dhe atij demokratik në thelb dhe në formë, në ligje dhe në mjete, në vlera dhe në sjellje. Në sistemin islam nuk i jepet pushteti atij që e kërkon, ndërsa në demokraci kjo është normale. Në sistemin islam të parin e zgjedhin njerëzit “*ehlul hali vel akd* - njerëzit më të ditur, më me përvojë dhe më të devotshëm”, kurse në sistemin demokratik kushdo mund të kandidojë dhe për zgjedhjen e të parit ka të njëjtën vlerë si i dituri edhe i padituri, si ai që merr vesh nga qeverisja dhe ai që s’merr vesh fare, si ai që është i devotshëm edhe ai që nuk është i tillë. Duke qenë se ka ndryshime të mëdha mes tyre, në sistemin islam krejt natyrshëm protestat apo demonstratat klasifikohen si kryengritje apo si “*huruxh* - rebelim”. Kështu pëlqimi i mjeteve të sistemit demokratik, duke i quajtur si pjesë e sistemit islam është një devijim. Por kohët e fundit po bëhet një propagandë shumë e fortë përmes rrugëve të shumta, sidomos nga kanale televizive të fuqishme arabe, çka po bën që shumë muslimanë të ngatërrojnë mjetet islame me ato jo-islame, sistemin islam me atë demokratik. Për pasojë, para thirrësve të vërtetë për ringritjen e sistemit të mirëfilltë islam krahas të tjerave po paraqiten edhe pengesa e deformime të shumta, që po i

përhapin në masën e njerëzve përkrahësit e sistemit demokratik. Një punë të pandalshme në këtë drejtim po bëjnë që prej dhjetë vitesh edhe disa kanale televizive, të cilat kanë arritur të shfrytëzojnë disa figura islame, ose disa ngjarje të botës islame për të fituar popullaritet dhe shikueshmëri të lartë.

Por nëse muslimanët jetojnë në një vend ku nuk ka shtet islam të mirëfilltë, pra, kur ndodhen në një shtet që i lejon mjete të tilla për arritjen e të drejtave, atëherë muslimanëve iu lejohen protestat paqësore për mbrojtjen e interesave të tyre. Pikërisht këtu vlen rregulli që përmenda më sipër. Kemi dëshmi nga koha e Pejgamberit për rregullin e përdorimit të një mjeti, që nuk përdoret nën hijen e zbatimit të Sheriatit:

1- *Xhivari* (kërkimi i strehimit ose mbrojtjes). Kjo ka qenë një praktikë e xhahilijetit, sistemit fisnor, e cila nuk lejohet të përdoret nën hijen e sistemit islam, por lejohet kur lind nevoja për të nën hijen e një sistemi joislam, që njeh edhe praktika të tilla. Prandaj kjo praktikë nuk u përdor më në shtetin Islam, por vlen si argument për mjetet që njohin sistemet e tjera në rast nevojë, kur muslimani jeton nën hijen e tyre. Sistemi i *xhivarit* që njihej në kohën e xhahilijetit ndryshon nga akti i sigurisë, që ka të drejtë ta japë çdo musliman për një jomusliman.

2. *Hilfi* (besëlidhja për mbrojtjen e interesave të njerëzve të dëmtuar). Pejgamberi thotë: “**La hilfe fil Islami ue ejema hilfin fil xhahilijeti ma zadehul islamu ila sheden** - Nuk bëhet besëlidhje për mbrojtjen e interesave të njerëzve të dëmtuar në Islam, sepse besëlidhjet e kohës së xhahilijetit u zëvendësuan nga rregullat e Islamit, të cilat garantojnë një mbrojtje akoma më të mirë për interesat e të dëmtuarve”. Kështu është kuptimi dhe shpjegimi i këtij hadithi. Besëlidhja për mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjen e të dëmtuarve ka qenë një mjet i kohës së xhahilijetit. Por kur u vendos shteti

islam nuk ishte më i nevojshëm, sepse shteti islam ka mekanizmat dhe mjetet e veta për mbrojtjen e të drejtave, madje dhe akoma më mirë sesa ato të xhahilijetit, por me kusht që të vihen siç duhet në zbatim, prandaj edhe Pejgamberi thotë: **“Ma zadehul islamu ila sheden** - *Besëlidhjet e kohës së xhahilijetit për mbrojtjen e të dëmtuarve janë theksuar dhe më shumë nga ligjet dhe mjetet e Islamit për mbrojtjen e tyre*”. Kështu besëlidhje të tilla nuk lejohen në një shtet të mirëfillte islam, por lejohen kur lind nevoja për to në një sistem tjetër, që ka praktika të tilla. Atëherë në kushtet e një sistemi që njeh si mjete për mbrojtjen e të drejtave apo mbrojtjen e të dëmtuarve: - avokatinë. - protestën paqësore. - grevën e urisë (pa shkuar deri në vdekje). - grevat e punëtorëve. - formimin e shoqatave, komisioneve, sindikatave etj. - pjesëmarrjen në zgjedhje. - ngritjen e padive në gjykatë...

Të gjitha këto pra shndërrohen në mjete të ligjshme, nëse shihen të nevojshme për gjërat që u takojnë muslimanëve, përderisa nuk shkaktojnë ndonjë dëm që është më i madh, sesa interesi që do të mbrohet apo që synohet të arrihet. Rregulli i mësipërm është i qartë për të gjitha këto. Dhe në fakt ky është qëndrimi i dijetarëve të *daves selefije*. Ky qëndrim nuk është produkt i ngjarjeve të fundit. Këtë e kam dëgjuar nga dijetarët *selefij* prej më se dhjetë vitesh. Dhe mund t'u përmend edhe emrat. Ndërsa ata që shprehen ndryshe, duke e quajtur veten respektues rigorozë të *menhexhit selefij*, në fakt nuk janë dijetarë. Ata kanë dëgjuar kritikën ndaj demonstratave, por nuk e kanë kuptuar mirë se për çfarë bëhet fjalë. Demonstratat nuk janë menhexh për të ngritur shtetin islam, apo për të vendosur Sheriatin, sepse Pejgamberi nuk e bëri kështu shtetin apo ndryshimin, megjithëse ishte nevoja. Pikërisht kjo është ajo që kritikojnë disa selefij. Protestat nuk bëhen gjithashtu dhe

“Ata që shprehen ndryshe, duke e quajtur veten respektues rigorozë të menhexhit selefij, në fakt nuk janë dijetarë. Ata kanë dëgjuar kritikën ndaj demonstratave, por nuk e kanë kuptuar mirë se për çfarë bëhet fjalë...”

nën një sistem diktatorial, sepse nuk i arrin dot të drejtat dhe shkaktojnë dëme më të mëdha, dhe kjo është ajo që kritikonin dijetarët. Por mbështetja e një grupi për të hequr qafe një tjetër më të keq, siç ndodhi në Egjipt është e ligjshme. E veçanta e dijetarëve *fukaha rabanijunë* është koherenca në kohë fitnesh (trazirash), largpamësia dhe qëndrimi i duhur. Rregullat e tyre nuk ndryshojnë, sepse ata ecin me menhexhin e Pejgamberit.

Kështu, në lidhje me mjetet e mësipërme hasim dy qëndrime ekstreme: 1- Ata që i quajnë si mjete të ligjshme edhe nën hijen e shtetit islam, duke sjellë kështu bidate në islam dhe duke përzier mjetet e islamit me mjetet e sistemeve të tjera, gjë që çon në mënjanimin ose dobësimin e mjeteve islame. 2- Ata që nuk e pranojnë përdorimin e mjeteve të mësipërme, qoftë edhe nën hijen e një sistemi joislam, duke u bërë kështu pengesë që muslimanët të mbrojnë të drejtat e tyre dhe duke qenë krejt në kundërshtim me udhën e Pejgamberit *alejhi salatu ue selam*, në kushtet kur mungonte shteti islam dhe mjete që njeh ky shtet për mbrojtjen e të drejtëve.

B. Një pjesë e selefijve e kuptuan shumë vonë, që po finalizoheshin të gjitha mundësitë për përmbysjen e regjimit dhe vendosjen e një regjimi të ri. Por kishte selefij, që këtë gjë e kuptuan shumë mirë dhe

prandaj i mbështetën që në fillim. Po kështu pati prej tyre që heshtën, ngaqë e kuptonin se situata nuk ishte si herët e tjera. Tashmë ujqërit e vjetër dhe bijtë e tyre po haheshin me njëri-tjetrin, kështu që islamikët duhet të shfrytëzonin momentin për të larguar sherrin më të madh. Dhe kjo – elhamdulillah – u realizua. Kjo tregon se disa selefijve iu mungonte përvoja dhe informacioni mbi aktualitetin. Megjithatë pati selefij, që iu bashkëngjiten shesheve të çlirimit që në fillim. Demonstruesit në Sheshin “*Tahrir*” kaluan një moment kulmant, në natën kur u ndeshën me *baltaxhinjtë* (cubat e regjimit). Po të mos bëhej qëndresë në këtë natë, protesta mund të dështonte dhe regjimi mund të mos rrëzohej. Në këtë natë bënë rezistencë dhe përleshje me *baltaxhinjtë* një dhjetë mijë të rinj selefij dhe ihvanë, sepse të tjerët ishin gati të largoheshin. Pra, ata thyen përpjekjen e fundit të regjimit, dhe nga ky moment regjimi deklaroi kapitullimin. Të mos harrojmë se këtu patën një kontribut të çmuar dhe selefijtë, që shumë njerëz nuk e dinë.

C. Për rastin e Egjiptit kemi atëherë tre qëndrime të selefijve: 1- Mbështetja e protestës. 2- Heshtja. 3- Kundërshtimi i protestës. Ky i fundit që qëndrim i gabuar.

H. Ka gjëra të dëmshme që sjellin dhe hair. Natyrisht që ihvanët tashmë në Egjipt kanë fituar pikë më shumë dhe kanë popullaritet ndoshta më të madh. Nga ana tjetër, ka qarqe që kanë vënë në shënjestër thirrjen selefije, sepse e shohin si rrezikun më të madh. Si rrjedhim, shumica e mbështetjes do të shkojë për ihvanët dhe partitë e tjera, e kështu selefijtë inshallah nuk do të merren me politikë, por do të vazhdojnë me thirrjen dhe edukimin e njerëzve. Pra, kjo bën që të angazhohen për përgatitjen e kushteve për një fitore të gjithanshme. Ndërsa me ndryshimet e

deritanishme, sipas të gjitha palëve, thjesht janë krijuar më shumë mundësi për thirrje dhe edukim të njerëzve në Islam. Duke marrë parasysh sa më sipër mund të thuhet, se edhe deklarimi i disa selefijve për të hyrë në parlament është nxitim. Megjithatë, e theksoj se dijetarët e Egjiptit i shohin punët e tyre më mirë. Pas dhunës që karakterizoi periudhën e kaluar, si nga ana e fuqive botërore, që synonin të vendosnin sistemin demokratik me dhunë, edhe nga regjimet diktatoriale, që nuk lejonin ringritjen e shtetit islam, tashmë elitës së muslimanëve që punojnë për rigjallërimin dhe rimëkëmbjen e Umetit iu duhet të përfshihen fuqishëm dhe pareshtur në ballafaqimin ideologjik dhe praktik, por në kushte mbase paqësore, mes projektit për vendosjen e sistemit islam dhe sistemit demokratik. Ballafaqimi i radhës nuk duhet të shihet shumë i lehtë, ndonëse përkrahësit e projektit islam tashmë kanë një përvojë të gjerë. Për fitoren e këtij ballafaqimi paqësor mund të bëhen pengesë edhe një pjesë e atyre që deri dje ishin në opozitë me regjimet, pasi qarkullon ideja se nuk ka mospërputhje mes projektit islam dhe demokracisë! Nëse mbështetësit e demokracisë shohin se po e humbin betejën në ballafaqimin paqësor, nuk është e çuditshme që të prodhojnë skenarë për t’iu kthyer sërish ballafaqimit të dhunshëm. Një rast konkret është Algjeria, ku armiq të projektit islam dështuan me ballafaqimin paqësor dhe prodhuan skenarët e dhunës. Shpresojmë se elita e Umetit tashmë e ka përvojën për të mos rënë në gracka të tilla. Kështu, të gjithë treguesit të çojnë në përfundimin, se finalizimi i projektit islam është në hapat e fundit. Së fundi, e lus Allahun t’u japë sukses muslimanëve për ngritjen e shtetit të mirëfilltë islam dhe për ndryshimin e gjendjes së Umetit. ■

IZRAELI NUK NDRYSHON QËNDRIMIN PËR KOSOVËN

Ambasadori i Izraelit në Beograd, Artur Koll ka thënë se nuk ka ndryshim të qëndrimit të Izraelit ndaj Kosovës. Pasi ka folur për nevojën e krijimit të shtetit të Palestinës dhe siç ka thënë ai, për dëshirën e Izraelit për këtë shtet, Koll ka shfaqur frikën se ky shtet mund të njihet nga Kombet e Bashkuara dhe ai këtë gjë e ka quajtur të rrezikshme. Në një intervistë për gazetën serbe *Večernje Novosti*, i pyetur nëse sheh ngjashmëri ndërmjet Palestinës e Kosovës, Koll është përgjigjur se “ato janë dy çështje të ndryshme”. Ndërsa në konstatimin e gazetës, se Izraeli i mbetet qëndrimit të mos e njohë pavarësinë e Kosovës, Koll ka thënë se nuk ka ndryshim në qëndrimin e Izraelit, se konfliktet duhet të zgjidhen me negociata dhe me marrëveshje të drejtpërdrejta bilaterale. “Izraeli nuk i përkrah aksionet e njëanshme”, citohet të ketë thënë ambasadori Koll, raporton Telegrafi. ■

NDËRTOHET XHAMIA MË E MADHE

Myftiu i Komunës “Bajram Pasha” të Stambollit të Turqisë, **Izet Shener**, gjatë një vizite në Mitrovicë ka prezantuar projektin për ndërtimin e një xhamie të re në qendër të qytetit, e cila, sipas tij, do të jetë xhamia më e madhe që ka pasur ndonjëherë Kosova. Myftiu Shener, pas një takimi me kryetarin e komunës së Mitrovicës, **Avni Kastrati**, tha se ndjehet mirë që gjendet në Mitrovicë, komunë kjo me të cilën komuna e “Bajram Pashës” në Stamboll mban kontakte vëllazërore. Xhamia e re, më e madhja dhe më moderne në Kosovë, do të ndërtohet në qendër të qytetit, në vendin ku tani ndodhet Xhamia “Isa Beg”, apo siç njihet nga qytetarët, Xhamia e Zallit, e cila do të rrënohet, pasi është dëmtuar gjatë luftës nga kriminelët serbë. Ajo do të ketë rreth 2.500 metra katrorë hapësirë të shfrytëzueshme, duke përfshirë këtu edhe hapësirat për mësim-besim dhe do të ketë dy minare me lartësi prej 48 m. Punët në realizimin e këtij projekti pritet të fillojnë së shpejti, ndërsa përfundimi i xhamisë në tërësi shpresohet të bëhet brenda një afati dyvjeçar. ■

PANAIRI I PRISHTINËS, BOTUESIT TË PAKËNAQUR ME SHITJET

Panairi Ndërkombëtar i Librit në Prishtinë. Ky ishte edicioni i parë i organizuar nga Unioni i Botueseve të Kosovës, një panair që i shtohet atij që do të organizohet nga Shoqata e Botuesve në qershor. Ky panair hapja e të cilit u shoqërua me polemika, u çel më 3 maj dhe u mbyll në datën 9 maj. Por duket se në përfundim të tij, botuesit nuk kanë qenë shumë të kënaqur nga shitja e librave. Rreth 80 shtëpi botuese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi etj., u kanë ofruar lexuesve rreth njëmijë tituj librash të rinj. Një pjesë e atyre që iu përgjigjën ftesës së këtij panairi janë skeptikë, nëse pas një muaji do të vijnë sërish në Prishtinë për panairin tjetër, duke qenë se për ta është kosto financiare. ■

NË MITROVICË DO TË KISHA NË KALANË E SHKUPIT DO TË NDËRTOHET

Kisha në Kalanë e Shkupit, objekti kontestues për të cilin u bë mjaft zhurmë do të ndërtohet, nëse Qeveria e ardhshme udhëhiqet nga VMRO- DPMNE-ja. Në “Manifestin” që prezantoi kjo parti para pak ditëve në pjesën e lokaliteteve arkeologjike thuhet se në Kalanë e Shkupit do të vazhdohet me konservim, restaurim dhe rekonstruktiv të objekteve arkeo-arkitektonike, në të cilat do të vendosen “gjetjet arkeologjike”. “Kjo në fakt paraqet një mesazh të qartë, se VMRO-DPMNE nuk ka ndërmend të heqë dorë nga ndërtimi i Kishës në Kala. Dëshëm apo s’dëshëm ne kisha tashmë është ndërtuar gjatë mandatit të kaluar të Qeverisë, por është e qartë se VMRO-DPMNE nuk i ka marrë seriozisht vërejtjet e BDI-së kundër ndërtimit të kishës dhe do të vazhdojë me ndërtimin e saj edhe pas zgjedhjeve të 5 qershorit nëse fiton një mandat të ri”, vlerësojnë ekspertët shqiptarë për trashëgiminë kulturore. ■

PALESTINË: FATAHU DHE HAMASI NËNSHKRUAN PAJTIMIN

Organizatat politike palestineze *Fatah* dhe *Hamas* kanë arritur një marrëveshje për formimin e një qeverie të përkohshme dhe kanë caktuar një datë për zgjedhje të përgjithshme, theksoi shërbimi informativ egjiptian. Ndërsa tani gjërat kanë ndryshuar. “Konsultimet u përmbyllën me marrëveshje për të gjitha pikat e diskutuara, përfshirë krijimin e një qeverie të përkohshme dhe përcaktimin e detyrave të veçanta për vendosjen e datës së zgjedhjeve të përgjithshme”, -theksojnë burime egjiptiane për Al-Xhaziran. ■

IZRAEL, SHBA: SHQETËSIM PAS MARRËVESHJES PALESTINEZE

Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara kanë reaguar me shqetësim pas shpalljes për arritjen e marrëveshjes për pajtim ndërmjet lëvizjeve palestineze *Fatah* dhe *Hamas*, që aktualisht kontrollojnë qeveritë në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës. Izraeli tashmë e ka hedhur poshtë perspektivën e qeverisë së unifikuar palestineze, që e përfshin *Hamasin*, duke thënë se paqja nuk do të jetë e mundshme, për shkak se *Hamas* vazhdon të bëjë thirrje për shkatërrimin e Izraelit dhe nuk ka hequr dorë nga dhuna. Në Uashington, Shtëpia e Bardhë, e cilësoi *Hamasin* si grup “terrorist” dhe tha se çfarëdo qeverie e ardhshme palestineze, që shpreson arritjen e paqes me Izraelin, duhet të shpallë se tërhiqet nga dhuna dhe ta njohë të drejtën e Izraelit për të ekzistuar. Prej vitit 2007, *Hamas* qeveris Rripin e Gazës, pasi e kishte përmbysur *Fatahun*, i cili nga ana tjetër ka nën kontroll vetëm Bregun Perëndimor./rel/ ■

EGJIPTI DO TË LËRË HAPUR KUFIRIN ME RRIPIIN E GAZËS

Egjipti do të lërë hapur për një kohë të gjatë kalimin kufitar me Rripin e Gazës për të zbutur bllokadën, që Izraeli ka ngritur kundër territorit palestinez. Këtë lajm e bëri të ditur ministri i jashtëm egjiptian, Al Arabi. Kalimi kufitar në Rafah është i vetmi, që nuk do të kontrollohet nga Izraeli. Egjipti e hapi këtë kalim vitin e kaluar vetëm për raste të nevojave humanitare. Pas marrjes së pushtetit nga *Hamas*, Izraeli në 2007 kishte ashpërsuar edhe më tej bllokadën e Rripit të Gazës./dw/ ■

“S’KA KTHIM NË KUFIJTË E VITIT 1967”

Kryeministri izraelit pritet të paraqesë “vizionin për paqe” para Kongresit Amerikan, por thekson se Izraeli “nuk mund të kthehet në kufijtë e pambrojtshëm të vitit 1967”. Gjatë fjalimit në konferencën e Komitetit Amerikano-Izraelit të Punëve Publike në Uashington, Netanjahu theksoi se Izraeli nuk mund të kthehet në kufijtë e pambrojtshëm të vitit 1967, -diçka që presidenti Obama e kishte sugjeruar pak ditë më parë. Netanjahu theksoi se “ky konflikt i ka rrënuar për gati një shekull, ngase palestinezët nuk duan t’i japin fund. Ata refuzojnë të pranojnë shtetin hebre. Kjo është arsyeja e vazhdimësisë së konfliktit.” ■

MINISTRI I JASHTËM EGJIPTIAN ZGJIDHET KREU I RI I LIGËS ARABE

Ministri i Jashtëm i Egjiptit, Nabil El-Arabi, është konfirmuar si udhëheqësi i ri i Ligës Arabe. Konfirmimi i tij bëhet vetëm disa orë para se 22 ministrat e jashtëm të organizatës, që ka 22 vende anëtare, u mbledhën që të gjejnë një zëvendësim për ish-ministrin e jashtëm egjiptian, Amër Musa, i cili ka lënë të kuptohet, se ai mund të kandidojë për President i Egjiptit. Katari e tërhoqi kandidaturën e vet për kreun e ligës pak para konfirmimit të El-Arabit, si Sekretar i Përgjithshëm. ■

solli: Genc Plumbi



BAZAT E PERCEPTIMIT DHE ARGUMENTIMIT NË ISLAM

Allahu i Lartësuar i ka tërhequr vërejtjen robërve të Tij ndaj të folurit pa dije, sepse një gjë e tillë domosdoshmërisht do t'i shpjerë në sajesa dhe shpërfytyrime të realitetit, gjë e cila e çon njeriun në humbje dhe devijim

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Kurani në kundërshtim me atë që ishin idhujtarët, vendosi baza reale dhe origjinale në aspektin e argumentimit dhe të perceptuarit, në mënyrë që udhëzimi të jetë i ndërtuar në baza të shëndosha dhe rregulla të qarta. Nga këto baza mund të

përmendim:

Lartësimi i dijes, ngritja e gradës së saj dhe përçmimi i injorancës.

Allahu i Lartësuar në Islam na urdhëron për t'u pajisur me dije: **“Dije (Mëso) *se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut*”**.¹ Madje sikurse e dimë të gjithë, ajetet e para të cilat kanë zbritur prej

¹ Muhamed: 19.

Kuranit janë pesë ajetet e para të Sures Alek, të cilat nxisin për dije: ***“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte”***.² Mbështetja në dije, patjetër që do të hedhë poshtë legjendat e nuk do të lejojë ndikimin e tyre, po ashtu dija e bën njeriun të pavarur prej imitimit të verbër të njerëzve të humbur apo injorantë, nga ana tjetër do ta bëjë atë një person të ekuilibruar në fjalët dhe veprat e veta. Ndaj dhe fjala e Allahut: ***“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mentarët i pranojnë këshillat!”***³, është një shtysë dhe një sinjal, që njeriu të kërkojë dije, sepse kështu do të mund që besimin, fjalët dhe veprat e tij të jenë të pranuar, konform udhëzimit dhe me bazë të shëndoshë.

Singeriteti dhe paanshmëria në kërkimin dhe pasimin e të vërtetës.

Singeriteti është zemra dhe esenca, e cila e udhëheq njeriun drejt arritjes së të vërtetës. Po ashtu nëse shohim Profetin *sal-lallahu alejhi ue selem* do të gjejmë se ai ka pranuar zakone dhe vepra, që gjendeshin në injorancë, porse ai i ngriti dhe i ndërtoi ato mbi baza të vërteta, larg syfaqësisë dhe kërkimit të famës, është pohuar se ai ka thënë: ***“Jam dërguar për të përsosur moralet e larta”***.⁴ Sigurisht që paanshmëria është një rrugë e cila e shpie njeriun drejt së vërtetës dhe rrugës së të udhëzuarve. Allahu thotë: ***“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejtë”***.⁵

Ndalesa e të folurit për Allahun pa dije.

“...Ndaj nisur nga ky aspekt gjëjmë se Islami urdhëron e nxit për shenjtërimin e teksteve fetare, për punimin me to...”

Allahu i Lartësuar i ka tërhequr vërejtjen robërve të Tij ndaj të folurit pa dije, sepse një gjë e tillë domosdoshmërisht do t'i shpjerë në sajesa dhe shpërftytyrime të realitetit, gjë e cila e çon njeriun në humbje dhe devijim. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Thuaj: “Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t’i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini”***.⁶ Kjo kërkon që njeriu të qëndrojë e të mos besojë diçka apo të thotë diçka tjetër, veçse pasi t'i sqarohet një gjë e tillë me dije të qartë.

Mbështetja në argumente dhe fakte.

Nga parimet më madhështore me të cilat dallohet feja Islame është dhe fakti se muslimani mbështetet në argumente dhe fakte, si dhe largohet e distancohet nga çdo hamendësim; një gjë e tillë kërkon që çështjet të shihen të balancuara dhe atë që e mbështet argumenti e marrim dhe punojmë me të, sepse ajo është e vërteta. Me anë të këtij parimi bien dhe shkatërrohen të gjitha mitet e besëtytnitë, madje të gjitha devijimet, të cilat nuk kanë asnjë lloj lidhje me këtë fe.

Me këtë parim kanë qenë të ndërtuara të

2 Alak: 1-5.

3 Zumer: 9.

4 Transmeton Ahmed. E ka saktësuar Ibën Haxheri dhe Hakim.

5 Enfal: 29.

6 Araf: 33.

gjitha mesazhet e profetëve. Allahu thotë në Kuran: ***“Thuaju (o Muhamed): “Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!”***⁷ Po ashtu i është drejtuar Profetit Muhamed *sal-lallahu alejhi ue selem* me këto fjalë: ***“Thuaju: “A i shihni ata që i adhuron në vend të Allahut? Më tregoni, çfarë pjese të Tokës kanë krijuar ata?! Mos vallë kanë ndonjë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni një libër të shpallur para këtij (Kuranit), ose ndonjë gjurmë tjetër të dijes hyjnore, nëse flisni të vërtetën!”***⁸

Nga ana tjetër e ka bërë të qartë se Ai i ka dërguar Profetët e Tij me argumente dhe fakte: ***“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejtë”.***⁹

Ndaj nisur nga ky aspekt gjejmë se Islami urdhëron e nxit për shenjtërimin e teksteve fetare, për punimin me to, bërjen e tyre gjykues në çështjet e paqarta dhe mos daljen prej tyre në aspektet, të cilat kanë të bëjnë me besimin dhe adhurimet. Kështu nëse do të shohim burimet nga ku muslimanët i ndërtojnë besimet dhe adhurimet, do të gjejmë se ato janë Kurani, fjala e Zotit tonë, e cila është fjala më e vërtetë dhe thënia më e drejtë, fjalë së cilës nuk i afrohet e kota në asnjë anë: ***“Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti, që meriton të gjitha lavdet”.***¹⁰

Pas tij vjen Suneti i Profetit, i cili nuk flet nga mendja e tij, por ajo është një shpallje, e cila iu dhurua atij. Allahu thotë: ***“Ai nuk flet***

“...Abdullahu u kthye nga ai, i dha një të sharë të atillë, që se kisha dëgjuar kurrë prej tij dhe i tha: “Të them ty fjalën e Profetit, ndërsa ti më thua do t'i ndaloj”!!!!....”

sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij”.¹¹ Ndërsa Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: ***“Më është dhuruar Kurani dhe diçka e ngjashme me të”.***¹²

Në kategorinë e tretë vjen unanimiteti (ixhmai) i këtij Umeti¹³, i cili ndërtohet pikërisht nga dy burimet pararendëse dhe ka një forcë të pakontestueshme, prandaj gjejmë se Allahu tërheq vërejtjen për kundërshtimin e tij, duke e shoqëruar këtë me një kërcënim, ku thotë: ***“Kushdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!”***¹⁴ Ndërsa Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: ***“Allahu nuk e bashkon Umetin tim (apo ndoshta ka thënë: Umetin e Muhamedit) në të kotën, dhe dora e Allahut është me xhematin (bashkësinë)”.***¹⁵

Disa shembuj nga të parët tanë të mirë

⁸ Ahkaf: 4.

⁹ Hadid: 25.

¹⁰ Fusilet: 42.

¹¹ Nexhm: 4-5.

¹² Ebu Daudi, saktësoi shejh Albani.

¹³ Sqarim: Nuk e kemi përmendur Kijasin (analogjinë) për faktin se ky parim hyn dhe funksionon në çështjet e fikhut (jurisprudencës) e jo në çështjen e akides, ndaj kije parasysh këtë!

¹⁴ Nisa: 115.

¹⁵ Tirmidhiu, e ka saktësuar shejh Albani.

në punimin me Sunetin e Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Na përcillet nga Abdullah ibën Omeri, se ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* të thotë: “Nëse gratë ju kërkojnë leje për të shkuar në xhami, mos i pengoni”. Ndërkohë Bilal ibën Abdullahu, i cili ishte aty dhe e dëgjoi këtë hadith tha: Pasha Zotin do t’i pengojmë. Abdullahu u kthye nga ai, i dha një të sharë të atillë, që se kisha dëgjuar kurrë prej tij dhe i tha: **“Të them ty fjalën e Profetit, ndërsa ti më thua do t’i ndaloj”!!!...**¹⁶

Abdullah ibën Zubejr Humejdiu përcjell, se imam Shafiu një ditë tregoi një hadith të Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe unë e pyeta: A punon me këtë hadith? Ai m’u përgjigj: “Mos më ke parë gjë të dal nga kisha e me litar në brez¹⁷, që të tregoj hadithin e Profetit e të mos punoj me të!”¹⁸ Një gjë e tillë është përmendur edhe me Ibën Huzejmen Allahu e mëshiroftë.

Në realitet shembuj të tillë në historinë e ndritur të dijetarëve të Islamit kemi pambarim, dhe nuk është mundësia t’i përmendim këtu të gjithë, por mjaftojnë këto dy shembuj për të na treguar, se si ata i shenjtëronin tekstet e Sheriatit dhe të qëndruarit tek ato, ndaj dhe Allahu iu dha sukses e i bëri imamllarë të kësaj feje e të udhëzuar.

Urdhërimi për meditim në krijimin e Allahut dhe faktet e Tij në gjithësi. Tekstet të cilat flasin për një gjë të tillë kanë ardhur në mënyrë masive, me to Allahu urdhëron krijesat e Tij, që të meditojnë rreth asaj që shohin e gjendet rreth tyre. **“Vërtet, atyre**

që mohojnë pasi patën besuar dhe pastaj e shtojnë mohimin e tyre, nuk do t’u pranohet pendimi (kur janë me shpirtin në grykë). **Pikërisht këta janë ata që kanë humbur. Nuk ka dyshim se atyre që e mohojnë besimin dhe vdesin mosbesimtarë, nuk do t’u pranohet asnjë shpërblesë, edhe sikur ajo të ishte sa e tërë toka e mbuluar me ar. Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe askush nuk do t’u ndihmojë”**.¹⁹

Të meditosh rreth kësaj gjithësie dhe mrekullive të saj, vështirimi i tokës e ç’gjendet në të, patjetër që do ta udhëheqë njeriun në besimin e vërtetë tek Allahu. Ndaj dhe duke u nisur nga ky fakt, Allahu zbriti në librin e Tij shembuj të qartë, në mënyrë që të ishin sa më të kuptueshme, të kapshme e gjurmëlënëse. **“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kuran për çdo gjë, për t’ua vënë veshin”**.²⁰ Nga ana tjetër Kurani ka sjellë edhe historitë e popujve të mëparshëm dhe fundin e tyre, në mënyrë që të jenë si një mësim e të shohin njerëzit, se cili ishte fundi i atyre që i shpërfillën argumentet e Allahut dhe këshillat e profetëve të tyre. **“Në tregimet e atyre** (të dërguarve) **ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kuran) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre** (librave), **që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit besimtarë”**.²¹ ■

■¹⁶ Imam Muslimi, kapitulli i Namazit: 442.

¹⁷ Ka si qëllim priftin, pra, a mos të dukem gjë si prift.

¹⁸ Virtytet e Shafiut të Imam Bejhakiut: 1/474.

¹⁹ Ali Imran: 90-91.

²⁰ Zumer: 27.

²¹ Jusuf: 111.

ME ALLAHUN E LARTËSUAR

T'i mësosh emrat e Allahut dhe cilësitë e Tij është një pasuri për besimtarin në këtë botë dhe në botën tjetër. Kush i mëson emrat e Allahut, ka një besim të paluhatshëm dhe u bën ballë sprovave dhe telasheve të kësaj bote

SHKRUAN: ULVI FEJZULLAHU

I lavd-falënderuar është Allahu i Lartësuar. Ai që i meriton salavatet dhe selamet është Muhamedi dhe familja e tij.

Për besimtarin është shumë me rëndësi që të jetë me Allahun vazhdimisht, kur është i fortë dhe i dobët, i pasur dhe i varfër, i gëzuar dhe i hidhëruar, i ri dhe i vjetër.

*Me Allahun në fluturimin e mendimeve,
Me Allahun në vështrimet e syrit.*

*Me Allahun në momentet e gjumit,
Me Allahun kur je edhe zgjuar.*

*Me Allahun kur zemra është hutuar,
Me Allahun kur shpirti ankon e rënkon.*

*Me Allahun në të sotmen e përfunduar,
Me Allahun në të nesërmen e pritur.
Me Allahun në çastet e fëmijërisë,
Me Allahun kur dobësohesh në pleqëri.*

*Me Allahun para dhe gjatë jetës,
Me Allahun pas saj në varr.*

*Me Allahun seriozisht në punët tona,
Me Allahun kur jemi në takimet e mbrëmjes.*

*Me Allahun kur i duam të devotshmit,
Me Allahun edhe kur i urrejmë të këqijtë.*

Biseda për njerëzit e mëdhenj, imamët e historisë, të Islamit, të diturisë e kulturës vërtet është një gjë e bukur. Por edhe më e bukur është kur bisedon dhe kujton siren, jetëshkrimin e peygamberëve të Allahut, sidomos për imamin e tyre, Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ndërsa ajo edhe më e bukura, më e mira dhe më e larta është kur njeh Allahun e Lartësuar. Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: “Njihe Allahun kur je mirë, që të të njohë në nevojë.” (Shënon Ahmedi)

Do ta njohësh Allahun e Lartësuar duke i lexuar dhe kuptuar emrat e Tij të bukur dhe



“Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, iu ka lutur Allahut me emrin e Tij të madh, që kur lutet me atë i përgjigjet dhe kur të kërkojë i jepet...”

Allahun e Lartësuar, iu lut dhe e thirri, por ishte vonë.

“Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?! Sot do të shpëtoj më vetëm trupin tënd, që të bëhesh mësim për ata që vijnë pas teje.” (Junus: 91-92)

Të nderuar! Mendoni dhe parafytyroni përfundimin e njerëzve zullumqarë, tiranë e diktatorë, Hitlerin, Stalinin, Enverin, Millosheviçin etj.

Allahu im! Të lutem mos na sprovo në këtë mënyrë! Vallë, pse besimtari të mos jetë i dëgjueshëm, të jetë më afër Allahut? Kjo nuk të pengon të përjetosh kënaqësitë e lejuara të dynjasë; të mirat e kësaj bote me besim (iman) shtohen edhe më tepër. Koha më e mirë dhe më e begatshme është kur robi është afër Zotit të tij, duke e përkujtuar, falënderuar, adhuruar dhe përgjyruar. Zoti yt është afër teje, kur ti mendon, kur zemra pulson, sepse nata dhe dita jote janë në dorën e Allahut të Lartësuar. Atij asgjë nuk i fshihet. Allahu i Lartësuar i tha Musait *alejhis selam* dhe Harunit *alejhis selam*: **“Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh.”** (Taha: 46) Ki kujdes dhe bindu se Allahun e ke më afër se ç’mendon:

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.” (Kaf: 16)

I nderuar! Patjetër që duhesh ta njohësh Allahun e Lartësuar. Kjo arrihet duke u njohur me emrat dhe cilësitë e Allahut

cilësitë e Tij të larta. Njohja e Allahut do të thotë ngushëllim për të pikëlluarit, siguri për të frikësuarit, krenari për të shtypurit, fuqi për të dobëtit, pasuri për të varfrit. Të gjithë njerëzit kanë nevojë për Allahun e Lartësuar, të mëdhenjtë, kryetarët, mbretërit, të pasurit, të gjithë kërkojnë prej Allahut. Kur e godet fatkeqësia, e kap brenga, sprovohet me sëmundje e të tjera, njeriu i kthehet Allahut duke klithur “o Allah”. Mos harro, se edhe ata që nuk besojnë, që e kanë harruar Allahun apo e mohojnë Atë, kur sprovohen e ndiejnë pafuqinë njerëzore dhe bërtasin me apo pavetëdije “o Allah”.

Vëlla! Motër! Kujto shefin e të pafeve Faraonin, i cili tha: **“Unë jam zoti juaj më i lartë!”** (Naziat: 24) **“O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje!”** (Kasas: 38)

Ishte po ai që me këtë bindje në momentet vendimtare të jetës së tij, pra të fundosjes në det tha: **“Besoj se s’ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit dhe unë jam ndër muslimanët.”** (Junus: 90) Besoi

Fuqiplotë. Allahu i Lartësuar ka thënë: ***“Allahut i përkasin emrat më të bukur, prandaj thirrreni Atë (lutuni Atij) me to”*** (Araf: 180)

I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Allahu i Lartësuar ka 99 emra, një më pak se njëqind. Vepro sipas tyre e do të hysh në xhenet. Allahu është vitër (tek) dhe e do vitrin.”* (Shënon Buhariu dhe Muslimi.) Atëherë lexojë Librin e Allahut për ta njohur Allahun, emrat e Tij janë të shumtë, libri i Tij nuk ka të sosur, fjalët e Zotit nuk përfundojnë. Kuptimet e fjalëve të Tij janë detyra, oqeane të pafund.

Lexo fjalën e Allahut: ***“Thuaj: “Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, sigurisht që ai do të shterej, para se të soseshin fjalët e Zotit tim, edhe sikur Ne të sillnim si ndihmë edhe një det tjetër si ai.”*** (Kehf: 109)

“Sikur të gjithë drurët, që gjenden në tokë të ishin pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Lukman: 27)

Të nderuar! Mësimi i emrave të Allahut është me rëndësi të madhe, sepse përmes mësimit të emrave të Allahut ne e adhurojmë Atë. Emrat e Allahut, përveç se janë emra në vetvete, zotërojnë edhe cilësi të plota. Emrat e Allahut i mësojmë në Kuran dhe Sunet.

T'i mësosh emrat e Allahut dhe cilësitë e Tij është një pasuri për besimtarin në këtë botë dhe në botën tjetër. Kush i mëson emrat e Allahut, ka një besim të paluhatshtëm dhe u bën ballë sprovave dhe telasheve të kësaj bote. Atëherë, le të njihemi me emrat e Allahut Fuqiplotë, t'i mësojmë dhe t'i përsërisim me bindje dhe besim e pa dyshim që do ta shijojmë ëmbëlsinë e njësimit të Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij.

Emri i madh i Allahut

“...mos harroni se lutja jo me zemër, dhe jo me seriozitet, nuk pranohet...”

*Me Allahun kur zemra është e thyer,
Me Allahun kur loti del.*

*Me Allahun në mëngjesin kur shndrit,
Me Allahun në mbrëmje kur hëna bën dritë.*

*Me Allahun kur plaga është rritur.
Me Allahun kur ashti është thyer.*

Me Allahun, çdo herë me Allahun.

Allahu i Lartësuar i njoftoi krijesat e veta me vetveten, me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të larta. A ka Allahu ndonjë emër të veçantë, që mund të cilësohet se vërtetë Ai ka emër të madh? Njerëzit a e dinë këtë apo nuk e dinë? Atëherë, nga Burejde ibën el-Husejbi *radijallahu anhu*, na tregohet se Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* e dëgjoi një njeri duke u lutur: **“ALLAHUME INI ESELUKE BI ENI ESHHEDU ENEKE ENTALLAH, LA ILAHE IL-LA ENTE, EL EHADU ESSAMEDU, ELEDHI LEM JELID UE LEM JULED, UE LEM JEKUN LEHU KUFUVEN EHAD.”**

“O Allah të lutem Ty, vërtetë unë dëshmoj se Ti je Allahu e nuk ka të adhuruar tjetër veç Teje, Je i Vetmi, Absolut që çdo gjë të përgjërohet, nuk lind e as nuk je i lindur dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë.” I Dërguari i Allahut tha: *“Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, iu ka lutur Allahut me emrin e Tij të madh, që kur lutet me atë i përgjigjet dhe kur të kërkojë i jepet.”* (Shënon Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu; Albani e vlerëson hadithin; sahih.)

Ky është argumenti për ekzistimin e

emrit të madh të Allahut të Lartësuar. Në lutje kemi disa emra të Allahut dhe në këtë grumbull të emrave të Tij është emri i madh i Allahut: **“ALLAHUME INI ESELUKE BI ENI ESHHEDU ENEKE ENTALLAH, LA ILAHE ILA ENTE, EL EHADU ESSAMEDU, ELEDHI LEM JELID UE LEM JULED, UE LEM JEKUN LEHU KUFUVEN EHAD.”**

Hadithi tjetër, nga Enesi *radijallahu anhu* thotë: Ishim ulur me të Dërguarin e Allahut, një njeri falej dhe më pas u lut duke thënë: **“ALLAHUME INNI ESELUKE BI ENNE LEKEL HAMD, LA ILAHE ILA ENTE, ELMENNANU, JA BEDIAS SEMAVATI UEL ERD, JA DHEL XHELALI UEL IKRAM, JA HAJJU JA KAJJUMU.”**

“Allahu im! Të lutem se me të vërtetë Ty të takon lavd-falënderimi, nuk ka të adhuruar përveç Teje, Bujar i madh, Shpikës nga asgjëja i qiejve dhe i Tokës, o vetëm Ty të takon madhështia dhe nderi, o i Gjallë, o i Përrjetshëm.” I Dërguari i Allahut tha: *“Vetëm se iu ka lutur Allahut me emrin e Tij të madh, që kur lutet me atë i përgjigjet dhe kur të kërkojë i jepet.”* (Shënon Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe; Albani e vlerëson: sahih)

Po edhe ky hadith tregon për emrin e madh të Allahut të Lartësuar. Ndërsa ajo që duhet ta themi është se në hadithin e dytë përmenden disa emra të Allahut, që nuk përmenden në të parin. Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* në të dy rastet tha: i është lutur Allahut me emrin e madh. Dr. Selman ibën Fehd elAude në librin *“Me Allah”* përmbledh emrat e Allahut të Lartësuar të thëna në të dy rastet, dhe emri i madh i Allahut është njëri në mesin e këtyre emrave të Tij:

“ALLAHUME INNI ESELUKE BI ENNI ESHHEDU ENNEKE ENTALLAH, LA ILAHE ILA ENTE, ELEHADUS SAMED, ELEDHI LEM JELID UE LEM JULED UE LEM JEKUN LEHU KUFUVEN EHAD, EL MENNANU, BEDIUS

SEMAVATI UEL ERD, DHUL XHELALI UEL IKRAM, EL HAJJUL KAJJUM.”

“O Allah të lutem Ty, vërtetë unë dëshmoj se Ti je Allahu e nuk ka të adhuruar tjetër veç Teje, Je i Vetmi, Absolut që çdo gjë të përgjërohet, nuk lind e as nuk je i lindur dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë. Bujar i madh, Shpikës nga asgjëja i qiejve dhe i Tokës, o vetëm Ty të takon madhështia dhe nderi, o i Gjallë, o i Përrjetshëm.”

Të nderuar! Atëherë kur robi i Allahut i drejtohet Zotit të vet dhe i lutet me bindje të thellë, me vendosmëri të sinqertë, Allahu i Lartësuar i përgjigjet lutjes së robit, ia lehtëson gjendjen e tij, ia plotëson dëshirën dhe ia jep atë që ai kërkon. Këto dua (lutje) kur janë bërë nga të dobëtit, të shtypurit, të varfrit, të persekutuarit, dhe nga çdo njëri që ka pasur halle dhe derte, shqetësim dhe preokupime Allahu i Madhëruar iu ka përgjigjur kërkesave të tyre. Por mos harroni se lutja jo me zemër, dhe jo me seriozitet, nuk pranohet. Lutuni te Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai me zemër, gjuhë dhe vepër, duke treguar përlulësi dhe varësi të plotë nga Allahu Fuqiplotë. ■

Referencat:

- “KURANI i madhërishëm”**, Përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi
“ME ALLAH”, Dr. Selman ibën Fehd el-Avde.
“ESMAULL-LAHIL HUSNA”, autorë: Muhamed Sad Abdudaim.
“EN-NEHXHUL ESMA FI SHERHI ESMAIL-LAHIL HUSNA, autorë: Muhamed el-Muahmud en-Nexhdijj
“EN-NUR EL-ESNA FI SHERHI ESMAIL-LAHIL HUSNA”, autorë: Emin ibën el-Hasen el-Ensarij
“VE LILAHIL ESMAUL HUSNA FEDUHU BIHA”, autorë: Ihda Talibat el-Ilm.



LIDHJA FAREFISNORE

"Detyrohet respektimi i lidhjes farefisnore me dashuri, me këshilla mes veti, me drejtësi, me dhënien e të drejtave detyruese dhe ato të pëlqyera, pastaj me shpenzime për të afërmin, dhe me mos përgojimin e të metave të tyre etj".

DR. EMIN IBËN ABDULLAH SHEKAVI

Farefisnia është njëri prej veprimeve më me vlerë dhe më me pozitë, më i bekuar dhe që bën dobi më shumë në këtë botë dhe në ahiret.

Farefisi i një njeriu nënkupton të afërmit e tij prej gjaku, si babai, nëna, vëllai, motra, djali, vajza dhe çdo person që ka lidhje gjaku me ta. Familja e gruas për burrin e saj nuk janë farefis, e as familja e burrit për gruan e tij nuk janë farefis, për shkak se mes tyre nuk ka lidhje gjaku, por mes tyre ekziston lidhje krushqie. Allahu azze ue xhel thotë: **"Edhe ata që u bënë besimtarë më vonë, që mërguan dhe luftuan bashkë me ju, janë vëllezërit tuaj; ndonëse, sipas Librit të Allahut besimtarët që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin. Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë."** Enfal 75.

Allahu azze ue xhel na porositi respektimin e farefisnisë, dhe e bëri këtë porosi shumë të afërt me porosinë e devotshmërisë. Allahu azze ue xhel thotë: **"Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkonit të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju."** Nisa 1.

Ibën Abasi thotë se komenti i këtij ajeti

është: **"Frikësojuni Allahut me respektimin e urdhrave të Tij, dhe largimin prej mëkateve që i ka ndaluar Ai, mos i shpëputni lidhjet farefisnore, por respektoni, vizitoni dhe silluni mirë me ato."**

Allahu azze ue xhel në ajetin: **"Jepja të drejtën e tij të afërmit, edhe të varfrit, edhe udhëtarit! Kjo është më e mirë për ata që e duan kënaqësinë e Allahut. Pikërisht ata do të jenë të fituarit"** Rum 38, na bën të qartë, se njeriu ndaj farefisnisë ka detyrime që detyrohet t'i kryejë, qofshin materiale apo morale.

Respektimi i lidhjes farefisnore ishte prej gjërave të para që thirri Muhamedi, **sal-lallahu alejhi ue selem**, kur iu shpall profecia. Buhariu dhe Muslimi përcjellin në librat e tyre tregimin e Ebu Sufjanit me Herakliun (mbretin e romakëve në atë kohë), se i pat thënë Ebu Sufjanit: **"Për çfarë ju urdhëron Muhamedi?"** Përgjigja e Ebu Sufjanit ishte: **"Ai na urdhëron që ta adhurojmë vetëm Allahun dhe mos t'i bëjmë shok Atij, t'i lëmë besimet e mëhershme dhe atë që thonë baballarët tonë, na urdhëron në faljen e namazit, dhe na urdhëron në sinqeritet, virtytshmëri dhe respektimin e farefisnisë."** (Buhari 7, Muslimi 1773).

Respektimi i lidhjes farefisnore është një prej shkaqeve që ta lehtëson furnizimin dhe ta zgjat jetën në dynja, kurse në ahiret është shkak që të fut në Xhenet dhe të mbron prej zjarrit të Xhehenemit. Buhariu dhe Muslimi përcjellin në librat e tyre, prej hadithit të Ebu Ejub Ensariut, *radijallahu anhu*, se Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, gjatë një udhëtimi iu paraqit një banor i shkretëtirës dhe e pyeti. “O i Dërguar i Allahut, më trego se cilat vepra më afrojnë Xhenetin e Allahut, dhe cilat vepra më largojnë prej Xhehenemit të Allahut?” – Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u ndal, i shikoi shokët e tij e pastaj tha: “Vetëm se u mbarësua, apo vetëm se u udhëzua.” – Pastaj tha: “Si the?” – Banori i shkretëtirës e përsëriti edhe një herë pyetjen e tij. – Pastaj Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “Ta adhurosh Allahun dhe mos t’i bësh shok Atij, ta falësh namazin dhe ta japësh zeqatin, ta respektosh farefisnin.” (Buhari 1397, Muslimi 13). Me një transmetim tjetër: “Nëse do ta praktikojë atë që i thashë, do të hyjë në Xhenet.” (Muslimi 13).

Në një hadith tjetër Enes ibën Maliku, *radijallahu anhu*, na përcjell se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Ai njeri që dëshiron t’i shtohet furnizimi dhe t’i zgjatet jeta, le t’i mbajë marrëdhëniet farefisnore.” (Buhariu 2067, Muslimi 2557).

Mosrespektimi i farefisnit dhe shkaputja prej tyre janë prej mëkateve të mëdha, që Allahu e paralajmëron dhe i premton vepruesit të tyre, se do ta ndëshkojë me dënime të ndryshme në këtë botë dhe ahiret. Allahu azze ue xhel thotë: “**Sa për ata që shkelin besëlidhjen me Allahun, pasi janë zotuar për atë, e që këpusin lidhjet** (familjare) **që ka urdhëruar Allahu të ruhen dhe bëjnë çrregullime në Tokë - mbi ta rëndon mallkimi dhe përfundimi i keq!**” Rad 25.

Buhariu dhe Muslimi në librat e tyre na përcjellin hadithin e Ebu Hurejrës, *radijallahu anhu*, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Pasi Allahu i krijoi të gjitha krijesat, lidhja farefisnore tha: “Unë kërkoj

“Respektimi i lidhjes farefisnore është një prej shkaqeve që ta lehtëson furnizimin dhe ta zgjat jetën në dynja, kurse në ahiret është shkak që të fut në Xhenet ...”

*strehim te Ti nga këputja e lidhjes farefisnore.” Allahu azze ue xhel tha: “Po, a nuk dëshiron që të mbaj lidhje me atë që mban lidhje me ty dhe t’i ndërpres me atë që i ndërpret me ty?” Ajo tha: “Po, si jo o Zoti im.” Allahu azze ue xhel tha: “Ajo është për ty.” Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “Lexoni nëse dëshironi: “**A pritet prej jush** (hipokritëve), **që nëse merrni sundimin** (ose zmbarseni prej fesë islame) **të bëni trazira në tokë dhe të ndërpritni lidhjet e akraballëkut?”** Muhamed 22. (Buhariu 5987, Muslimi 2554)*

Transmeton imam Tirmidhiu në Sunenin e tij prej hadithit të Ebu Bekrete, *radijallahu anhu*, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “S’ka mëkat që e meriton më shumë përshpejtimin e dënimit të Allahut, duke mos e vonuar atë në ahiret, siç është mëkati i bërjes padrejtësi dhe i shkaputjes së lidhjes farefisnore.” (Tirmidhiu 2511).

Ai që i ndërpret lidhjet familjare kanoset me mos-hyrjen e tij në Xhenet. Xhubejr ibën Mutimi, *radijallahu anhu*, na përcjell se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Nuk hyn në Xhenet ai që i kaput lidhjet farefisnore.” (Buhariu 5984, Muslimi 2556).

Respektues i lidhjes farefisnore konsiderohet ai person, i cili e respekton dhe e viziton farefisnin, edhe kur ata shkaputen prej tij dhe nuk e respektojnë. Përcillet prej Abdullah ibën Amër ibën Asit, *radijallahu anhu*, se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Nuk i mban lidhjet farefisnore ai që këmben vizitat, por është ai që kur e bojkoton farefisnia ai i rivendos lidhjet me ata.” (Buhariu 5991).

Transmeton imam Muslimi, *Allahu e mëshiroftë*, në Sahihun e tij prej Ebu Hurejrës, *radijallahu anhu*, se një njeri erdhi te Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe i tha atij: “O i Dërguar i Allahut! Unë kam disa të afërm me të cilët mbaj lidhje farefisnore, kurse ata nuk i mbajnë me mua, u bëj mirë, kurse atë më bëjnë keq dhe sillem butë me ta, kurse ata sillen me arrogancë ndaj meje. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “Nëse vërtet është ashtu si thua ti, atëherë është njësoj sikur t’i ushqesh ata me hi të nxehtë, dhe vazhdimisht do të jetë me ty një ndihmës i Allahut kundër tyre, përderisa je në këtë gjendje.” (Muslimi 2558).

Komentuesit e këtij hadithi thonë: “Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tregon dënimin e tyre se sa është i dhimbshëm, dhe i përngjanë me vuajtjet e ngrënësit të hirit të nxehtë. Kjo e tëra vjen si rezultat i shkëputjes së lidhjes familjare dhe arroganca e tyre ndaj atij që i viziton.”

Respektimi i lidhjes farefisnore arrihet me veprimin e mirësisë ndaj tyre, edhe kjo me atë çka mundet njeriu. Ebu Xhemreh, *Allahu e mëshiroftë*, thotë: “Farefisnia respektohet me pasuri, me ndihmë kur kanë nevojë, me buzëqeshje, me lutje për ta etj.”

Imam Kurtubiu, *Allahu e mëshiroftë*, thotë: “Detyrohet respektimi i lidhjes farefisnore me dashuri, me këshilla mes veti, me drejtësi, me dhënien e të drejtave detyruese dhe ato të pëlqyera, pastaj me shpenzime për të afërmin, dhe me mos përgojimin e të metave të tyre etj”.

Kuptimi i përgjithshëm i lidhjes farefisnore është respektimi i tyre sa mundet në të mirë, dhe largimin e sherrit prej tyre me sa ke mundësi. Pra, çdo send varet prej mundësisë dhe prej fuqisë së njeriut, pastaj prej gjendjes dhe prej pozitës së tij, dhe prej marrëdhënieve familjare dhe prej asaj, se sa i lehtësohet atij kjo gjë. Allahu azze ue xhel thotë: “*Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.*” Bekare 286.

Imam Neveviu, *Allahu e mëshiroftë*, thotë: “Pëlqehet t’i jepet përparësi nënës në

“S’ka mëkat që e meriton më shumë përshpejtimin e dënimit të Allahut, duke mos e vonuar atë në ahiret, siç është mëkati i bërjes padrejtësi dhe i shkëputjes së lidhjes farefisnore...”


dëgjueshmëri dhe mirësi, e pastaj babës, pastaj fëmijëve, pastaj gjyshave dhe gjysheve, pastaj vëllezërve dhe motrave, pastaj të gjithë mahremeve prej familjes, si xhaxhallarëve, dajallarëve, hallave, tezeve etj. Pra, i jepet përparësi më të afërmit, e pastaj tjetrit më të afërt dhe kështu me radhë.”

Hakimi në Mustredekun e tij na transmeton hadithin e Ebu Remtheh, *radijallahu anhu*, i cili thotë se e ka dëgjuar Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: “Nëna jote, pastaj babai yt, pastaj motra dhe vëllai, pastaj të tjerët me radhë me nivel më të afërt.”

Dhënia e lëmoshës në farefis e dyfishon shpërblimin e dhënësit të saj. Na përcjell Tirmidhiu prej Sulejman ibën Amirit, *radijallahu anhu*, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Lëmosha për fukaranë është vetëm lëmoshë, ndërsa për farefisnin lëmoshë dhe lidhje farefisnore.” (Tirmidhiu 658).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi prej hadithit të Mejmune bint Harith, *radijallahu anha*, e cila liroi një robëreshë, duke mos u konsultuar me Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe më vonë i tha Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “O i Dërguar i Allahut, a vërejte se e lirova robëreshën time? Tha: “A e bëre?” - Ajo tha: “Po.” - Atëherë i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i tha: “Po t’ia kishe dhuruar tezeve të tua, do të kishe më shumë shpërblime”. (Buhari 2592, Muslimi 999). ■

Nga arabishtja: Irfan Jahiu



Në këtë shkrim do të bëjmë ca vështrime rreth disa studimeve të reja shkencore, që flasin për rëndësinë e lidhjeve shoqërore, si dhe për faktin se mbyllja dhe izolimi çojnë në sëmundje të rrezikshme, si shpirtërore ashtu edhe fizike. Studiuesit e këtij lëmi pohojnë, se jeta shoqërore është shumë e dobishme për zemrën

ABDUDAIM KEHIL

Nuk duhet të habitemi pse mu në ajetin e parë të Kuranit, Allahu i Madhëruar e ka cilësuar vetën me dy cilësi të mëshirës, me fjalët: **“bismilahi rahmani rahim” - në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit** -

(Fatiha:1). S’do mend që me këtë synoi ta vërë në pah rëndësinë e mëshirës për besimtarin. Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet. Nëse dëshiron të të mëshirojë Allahu, mëshiroji ata përreth teje. Ata që e meritojnë më shumë mëshirën janë më të afërmit e tu, për këtë i Dërguari na urdhëroi t’i mbajmë fort lidhjet me të

afërmit.

Në këtë shkrim do të bëjmë ca vështrime rreth disa studimeve të reja shkencore, që flasin për rëndësinë e lidhjeve shoqërore, si dhe për faktin se mbyllja dhe izolimi çojnë në sëmundje të rrezikshme, si shpirtërore ashtu edhe fizike. Studiuesit e këtij lëmi pohojnë, se jeta shoqërore është shumë e dobishme për zemrën. Një studim amerikan flet se personi që nuk gëzon raporte të mira me shokët dhe anëtarët e familjes është më tepër i rrezikuar nga sëmundjet e zemrës. I madhëruar qoftë Allahu! A nuk është mu ky një detyrim me të cilin na ngarkoi Allahu para katërmbëdhjetë shekujve? Ajetet kuranore për këtë janë të shumta. I Dërguari në më shumë se një thënie theksoi, se kur një grumbull njerëzish ulen në një prej shtëpive të Allahut për të përmendur Allahun, ata rrethohen prej melaikeve, kaplohen nga mëshira dhe emrat e tyre i përmend Allahu. Këto fjalë aludojnë në braktisjen e izolimit dhe mbylljes në vetvete. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkossh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar.”*** (Kehf: 28) Le të ndalemi së bashku dhe të meditojmë mbi formulimin e ajetit ***“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre”*** këtu flitet në shumës ***“ata që lusin Zotin”***, që udhëzon drejt domosdoshmërisë së afrimit me besimtarët, pastaj thotë: ***“mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh”*** këtu urdhri është në njëjës, sepse ***“ujku ha delen që ndahet”***.

Vazhdojmë duke përmendur rezultatet

“Po i njëjti studim vjen në përfundim, se ky izolim nuk e përfshin femrën dhe se nuk ka dallim mes një femre të izoluar dhe një tjetre, që është aktive në raportet shoqërore...”

e këtij studimi, që vërtetuan se personi i izoluar në vetvete, në gjakun e tij paraqiten simptoma të infeksionit, duke u ngritur mesatarja e katër lëndëve prej tyre *“interleukin 6”*. Këto lëndë konsiderohen sinjalizues të infeksionit, që luajnë një rol të rëndësishëm për problemet arteriosklerozale. Po i njëjti studim vjen në përfundim, se ky izolim nuk e përfshin femrën dhe se nuk ka dallim mes një femre të izoluar dhe një tjetre, që është aktive në raportet shoqërore në kontekstin e reflektimit të këtyre raporteve shoqërore ndaj sëmundjeve kardiovaskulare.

Në studim përmendet se janë përfshirë 3267 burra dhe gra nga vise të ndryshme të SHBA-së dhe mosha e tyre mesatare ishte 62 vjeç.

Së këndejmi, ndoshta mund të kuptojmë urtësinë pse Allahu i urdhëroi burrat të kryejnë namazin me xhemat, kurse gratë nuk i ngarkoi me këtë detyrim. Gruaja me natyrën e saj e do shtëpinë e vet, fëmijët e vet dhe me këtë arrin lumturinë e vërtetë në dallim me burrin, të cilin Allahu e krijoi për të rendur nëpër tokë. Mu për këtë Allahu iu drejtua grave me fjalët: ***“Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj, si shfaqej në injorancën e hershme, falni namazin, jepni zeqatin dhe respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Allahu ka si qëllim që nga***

ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) ***të largojë ndyrësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj.***" (Ahzab: 33).

Kjo, sigurisht nuk nënkupton që gruaja duhet t'i braktisë të gjitha punët e dobishme, si mësimdhënien, thirrjen në rrugë të Allahut, ngase si burri ashtu edhe gruaja janë të barabartë përballë zhvillimit të çështjeve të përgjithshme të kësaj jete, mirëpo me një dallim që natyra e femrës duron më shumë izolimin apo qëndrimin në shtëpi, se natyra e mashkullit, ngase Allahu e veçoi me detyrën e edukimit të fëmijëve, mirëmbajtjen e shtëpisë, si dhe për të gjetur burri i saj qetësinë tek ajo.

Studiues britanikë, rreth kësaj çështjeje theksojnë, se njerëzit e izoluar janë ata që anojnë më shumë nga pirja e duhanit, kanë aktivitete të mekët, shkaqe këto që shtojnë edhe më tepër rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Erik Loks, mësimdhënës në Degën e Medicinës pranë Universitetit të Harvardit, në Boston, si dhe një pjesëmarrës i këtij studimi thotë: Analizat tona tregojnë se është më mirë për zemrën e një personi, nëse është tip shoqëror, në përgjithësi është më mirë për shëndetin e njeriut, nëse ka raporte të forta me familjen e ngushtë dhe të gjerë. Ai po ashtu duhet të ketë lidhje me shoqata shoqërore dhe fetare dhe të ketë partner në jetë.

I madhëruar qoftë Allahu! A nuk janë mu këto mësimet e Profetit të madh, lavdi dhe paqja e Allahut qoftë mbi te? A nuk na urdhëroi i Dërguari t'i mbajmë lidhjet me farefisin? A nuk është ai që na urdhëroi të jemi bamirës ndaj prindërve? A nuk na urdhëroi të martohemi duke thënë *"Kush shmang traditën time nuk është prej nesh?!"* Kur ai na urdhëroi me të gjitha këto, ai deshi për ne jetën e lumtur. A nuk erdhën studiuesit në këto përfundime pas kërkimesh të shumta?

Keti Roz nga Shoqata Britanike e Zemrës thotë: Rezultatet e këtij studimi përforcojnë disa studime të mëhershme, që tregojnë se personat e izoluar janë ata që anojnë më shumë nga pirja e duhanit dhe që janë më pak aktivë, dy faktor këto që shkaktojnë sëmundjet e zemrës. Programet e kësaj shoqate për rehabilitimin e atyre, që vuajnë nga sëmundjet e zemrës ofrojnë zgjidhje, duke rritur besimin te të sëmurët dhe duke luftuar ndjenjën e vetmisë tek ata.

Shikoni pra si përpiqen t'i rehabilitojnë të sëmurët, duke u munduar t'i kthejnë raportet shoqërore, sepse i kanë të humbura. Shikoni sa shumë të holla harxhojnë për të arritur këtë, duke paguar mjekë e sociologë, kurse këto mësimet ne i gjejmë në fenë tonë të pastër *"ai që ndërpret lidhjet me farefisin, nuk hyn në xhenet!"* Allahu për ata që ndërpresin lidhjet me farefisin, thotë: *"Pritet prej jush (hipokritëve), që nëse merrni sundimin (ose zmbropseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpritni lidhjet e akraballëkut? Të tillët janë ata që Allahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua verboi të parit e tyre."* (Muhamed: 22, 23), po ashtu ka thënë: *"Dhe ata që e mbajnë lidhjen për të cilën Allahu ka urdhëruar të mbahet, që frikësohen nga Zoti i tyre dhe nga llogaria e rëndë e përgjegjësisë."* (Rad: 21).

Studimi amerikan tërheq vërejtjen se depresioni e shton rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Në universitetin Emory në Atlanta është bërë një studim, ku vërtetohet se depresioni shkakton rrahje të pasistemuara të zemrës, gjë që shkakton rrezikun e vdekjes së befasishme.

Për këtë, pra, besimtari nuk dëshpërohet asnjëherë, porse e gjen atë vazhdimisht të gëzuar me mëshirën e Allahut, Ai thotë: *"E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni*

(shpirtërisht), *derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë.*" (Ali Imran: 139), po ashtu thotë: *"Thuaj: "Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme, se ajo që grumbullojnë ata."* (Junus: 58).

Dobitë e këtij shkrimi:

1. Besimtari mundohet t'i mbajë vazhdimisht lidhjet me farefisën, të afrohet me besimtarët e devotshëm dhe njëherazi kjo është rruga e profetëve; Ibrahim, *alejhi selam*, ka thënë: **"Zoti im, më dhuro mua urtësi dhe më bashko me të mirët!"** (Shuara: 83).

2. Shkenca vërteton dobitë e jetës shoqërore dhe lidhjes me të tjerët. Nga ana tjetër vërtetoi dëmet e izolimit dhe të vetmisë. Mu për këtë arsye i gjejmë mësimet islame, që e vejnë theksin mbi detyrimin e mbajtjes së lidhjeve me farefisën, përhapjes së përshëndetjes me selam dhe dashurinë për të mirën, gjersa i Dërguari thotë: *"Nuk ka besuar asnjëri prej jush përderisa të dojë për vëllanë atë që do për veten."*

3. Izolimi shpien në depresion, madje mund ta shpjerë njeriun deri në vetëvrasje, apo vdekje të befasishme. Për këtë arsye i Dërguari na urdhëroi të martohemi duke thënë: *"Rini, kush ka mundësi prej jush të martohet, le të martohet!"* Na urdhëroi t'u afrohem të mjerëve, t'i duam të varfrit, madje edhe pas vdekjes së një besimtari na urdhëroi ta përcjellim atë deri te varret!

4. Për sa i përket grave, nuk kanë ndonjë rrezik, nëse qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe kujdesen për fëmijët e tyre. Kjo, njëherazi vërteton edhe dallimin mes femrës dhe mashkullit. Allahu thotë: **"e mashkulli nuk është si femra"** (Ali Imran: 36). Mu për këtë arsye Allahu i urdhëroi

“...Tështë më mirë për shëndetin e njeriut, nëse ka raporte të forta me familjen e ngushtë dhe të gjerë...”

femrat të mos përzihen me meshkujt, përpos në raste të domosdoshme brenda kufijve të sheriatit. E urdhëroi atë të mbulohet, të qëndrojë në shtëpinë e saj dhe të respektojë bashkëshortin, përpos në raste kur preferohet për femrën të dalë nga shtëpia, nëse punon si mjeke, mësuese apo ndonjë punë tjetër të dobishme për shoqërinë, me kusht që të mos dëmtohet ajo, apo të mos dëmtojë dikë tjetër.

5. Të lidhesh me të tjerët, t'i ndihmosh ata, të afroresh me nevojtarët për t'u ndihmuar, është e dobishme dhe të mbron nga sëmundjet e zemrës. Për këtë arsye i Dërguari na urdhëroi t'i ndihmojmë atij që ka një vështirësi, të jemi si një fortesë e lidhur mirë apo si një trup, e Allahu thotë: **"dhe bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do bamirësit"** (Bekare: 195).

Lusim Allahun të na bëjë prej atyre për të cilët ka thënë: **"Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjyes, i urtë."** (Teube: 71). ■

Përktheu: Agim Bekiri

DISPOZITAT E MYSAFIRLLËKUT

Dijetarët e hershëm por edhe ata bashkëkohorë në librat e tyre i kanë dhënë një hapësirë të veçantë dispozitave të gostisë dhe promovimit të kësaj etike tek muslimanët në veçanti, por edhe tek jomuslimanët për të shpalosur dhuntitë e Islamit

PËRZGJODHI DHE PËRSHTATI: RASHIT ZYLFIU

Allahu i Madhëruar thotë: “A ke arritur të dëgjosh ti për rrëfimin e mysafirëve të ndershëm të Ibrahimit? Kur patën hyrë

tek Ai dhe thanë: “Të përshëndesim me paqe!” Ai tha: “Qofshi gjithnjë të përshëndetur me paqe!” (E me vete tha): “Njerëz të panjohur!” Dhe ai pa u vërejtur shkoi te familja e vet dhe solli një viç të



majmë të pjekur. Atë ua afroi atyre e tha: “Përse nuk po hani?”¹

Pejgamberi *sal-lAllahu alehi ue selem* thotë: “Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit mos t’i bëjë keq komshiut të vet. Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit le ta respektojë mysafirin e vet. Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit le të flasë të vërtetën apo le të heshtë.”²

Islami e vetmja fe e përzgjedhur dhe e pranuar nga Allahu i Madhëruar është i përsosur në të gjitha sferat e jetës. Njeriu si një qenie sociale dhe nevoja e tij e natyrshme për shoqërinë ka qenë qysh nga krijimi i tij. Islami për këtë nevojë që ndien njeriu solli dispozita dhe etika, duke vendosur baza dhe dispozita, që të ruhet kjo nevojë njerëzore. Dijetarët e hershëm por edhe ata bashkëkohorë në librat e tyre i kanë dhënë një hapësirë të veçantë dispozitave të gostisë dhe promovimit të kësaj etike tek muslimanët në veçanti, por edhe tek jomuslimanët për të shpalosur dhuntitë e Islamit. Duke u nisur nga natyra e rubrikës së fikhut ne do të fokusohemi tek dispozitat dhe disa etika, që kanë të bëjnë me gostinë dhe rregullat e mysafirllëkut.

Dispozitë dhe etikë: Kush është mysafir?

Mysafir konsiderohet çdo njeri që troket derën e dikujt, që ka nevojë për konak apo gosti. Mysafiri mund të jetë nga të afërmit, farefisi apo edhe njeri i huaj, që nuk e kemi njohur më parë.

Sa ditë ka të drejtë të qëndrojë mysafiri?

Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: “Mysafirllëku është tre ditë, shpërblimi i tij sa për të kaluar një ditë dhe natë³, nuk i lejohet burrit musliman që të

“...Në kohën e injorancës ishte traditë që të vinin në gosti para se të përgatitej ushqimi shumë herët duke e pritur atë, që të bëhej gati. Këtë ves Allahu e ndaloj... ”

qëndrojë tek vëllai i tij deri sa ai të mëkatojë. Të pranishmit i thanë: E si mëkaton? Tha: “Qëndron tek ai, e ai (nikoqiri) nuk ka çfarë t’i ofrojë.”⁴

Hadithi aludon se nuk i lejohet askujt të qëndrojë mysafir më shumë se tre ditë, për shkak se mysafiri mund ta vendosë në pozitë të vështirë nikoqirin, ose duke paragjykuar për mysafirin.

Hatabiu ka thënë: Nuk i lejohet mysafirit të qëndrojë më shumë se tre ditë pa kërkesën e nikoqirit, që mos të bie në pozitë të palakmueshme e ta humbë shpërblimin.

Respektimi i mysafirit është detyrim:

Imam Neveviu Allahu e mëshiroftë, ka përmendur konsensus për gostinë dhe se kjo është nga gjërat e përforcuara që ka sjellë Islami. Imam Neveviu më pas ka sjellë mospajtimin e dijetarëve mes asaj, se a është vaxhib (detyrim) apo sunet respektimi i mysafirit.

Maliku, Shafiu dhe Ebu Hanife e shohin sunet e jo vaxhib respektimin⁵ e mysafirit. Lejthi dhe imam Ahmed i thonë se është detyrim respektimi i mysafirit. Imam Ahmed i ka lidhur këtë me fshatarët e jo me qytetarët.

¹ Dharijatë: 24-27.

² Buhariu 6018, Muslimi 47.

³ Dhuratat që i dhurohen atij duhet që t’i mjaftojnë për të kaluar distancën e një dite dhe një nate.

⁴ Buhariu 6135, Muslimi 48/Libri i fikut të braktisur.

⁵ Me respektimin e mysafirit kem si qëllim t’i bësh konak, gosti etj.

Përgjigjja e ftesës:

Kanë ardhur shumë hadithe për përgjigjen e ftesës. Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: *Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë pesë:... përgjigjja e ftesës...*⁶

Shumica e dijetarëve thonë se përgjigjja e ftesës është mustehab (e pëlqyeshme) përveç ftesa për martesë, përgjigjja e saj është vaxhib (detyrim). Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Ushqimi më i keq është ushqimi i dasmës ku ftohen në te të pasurit e lihen të varfrit e kush nuk i përgjigjet ftesës ka mëkatuar ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij”*.⁷

Disa dijetarë kanë përmendur kushte për prezantimin e këtyre ftesave. Dijetari Muhamed Salih Utthejmin Allahu e mëshiroftë ka përmendur këto kushte:

Që ftuesi të mos jetë prej atyre që duhet të distancohemi nga ai.

Që mos të ketë ndonjë të keqe⁸ në vendin e prezantimit. Nëse ka mundësi mënjanimi i kësaj të keqeje detyrohet përgjigjja për dy shkaqe: Përgjigjja e ftesës dhe mënjanimi i së keqes. Nëse nuk ka mundësi mënjanimi i së keqes, atëherë prezantimi është i ndaluar.

Që thirrësi të jetë musliman përndryshe nuk detyrohet përgjigjja.

Që të fituarit e pasurisë mos të jetë haram, ngase prezantimi të mundëson ngrënien e haramit; këtë e thonë disa dijetarë, ndërsa grupi tjetër thotë: Se mëkati është për atë e jo për mysafirin, përveç nëse në esencë e ka pasurinë haram, si alkooli, mish i derri etj.

Që përgjigjja mos të jetë shkaktare për të anashkaluar ndonjë detyrim tjetër, apo detyrim më të madh se vetë përgjigjja e ftesës.

Që ftesa mos t'i shkaktojë probleme, si p.sh.: nevoja për të udhëtuar apo lënia e familjes që janë nevojtarë.

Kur ftesa nuk është e përcaktuar atëherë nuk është detyrueshme përgjigjja si: Të bëhet thirrja nga ana e nikoqirit në mënyra të përgjithshme pa përcaktim.

Pëlqimi e përshëndetjes, ngrohtësisë ndaj mysafirit:

Nga Ibën Abasi Allahu qoftë i kënaqur ndaj tij, na përcillet se ka thënë: “Kur erdhi një delegacion i Abdul Kajsit tek Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* i tha: *“Mirë se vjen!”*.⁹ Nuk ka dyshim se pritja e mysafirit me ngrohtësi dhe shprehje të mira mbjell tek ai gëzim, i jep rehati dhe komoditet. Realiteti e dëshmon një gjë të tillë.

Të tepruarit në mikpritjen e mysafirit:

Nuk ka nevojë që njeriu ta ngarkojë veten shumë për mysafirin sa t'i kalojë kufijtë, ngase ngarkimi i tepërt në përgjithësi është i ndaluar.

Përcillet nga Enesi Allahu qoftë i kënaqur ndaj tij, se ka thënë: “Ishim tek Omeri, *radijallahu anhu* dhe tha: *“Jemi ndaluar ta teprojmë (të ngarkohemi tepër)”*.¹⁰

Nuk ka ndonjë rregull që e përkufizon, se kur njeriu e tepron apo e ngarkon vetën jashtë mase, por këtë e përcakton tradita e rrethit ku ai jeton. Nëse njeriu përgatit ushqim për mysafirin, që nuk është i njohur në atë vend të përgatitet deri në atë mase ai veçse e ka ngarkuar veten apo i ka tejkaluar kufijtë.

Ndërsa ajo çfarë ndodh sot në gosti të ndryshme, ku ajo më shumë i përngjet një gare se sa lloje ushqimesh po shërbehen, se sa vetë qëllimi për çfarë janë të ftuar mysafirët e shumica e atij ushqimi më pas

⁶ Buhariu 1240, Muslimi 2162.

⁷ Buhariu 5177, Muslimi 1432.

⁸ E keqe mund të jetë si: përdorimi i alkoolit,

përzjerja burra me gra, muzika etj.

⁹ Buhariu 6176.

¹⁰ Buhariu 7293.

hidhet, kjo është israfi (shpërdorimi), që jemi të ndaluar ta bëjmë.

Hyrja me leje dhe largimi pas ushqimit me leje:

Allahu i Madhëruar thotë: ***“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) e mundojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; Allahu nuk i turpërohet realitetit.”***

Allahu i Madhëruar i ndaloi besimtarët të hyjnë në shtëpinë e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, pa lejen e tij. Dhe ky ndalim është për të gjithë besimtarët, që mos të hyjnë në shtëpitë e besimtarëve pa lejen e tyre.

Imam Sheukani thotë: “Allahu i ndaloi besimtarët, që të hynë në shtëpinë e Pejgamberit dhe kjo ndalesë i përfshin të gjithë. Dhe kështu njerëzit e respektuan etikën hyjnore për ta, dhe nuk hynin më pa leje derisa bëhej gati ushqimi e jo para se të përgatitej për ta pritur atë”.¹¹

Në kohën e injorancës ishte traditë që të vinin në gosti para se të përgatitej ushqimi shumë herët duke e pritur atë, që të bëhej gati. Këtë ves Allahu e ndaloi. Pastaj Allahu i Madhëruar e sqaroi, se pasi të hahet ushqimi duhet të merret leje për t’u larguar e mos të zgjatet në biseda, se kjo e rëndon nikoqirin, përveç nëse nikoqiri e kërkon një gjë të tillë, apo kjo është traditë tek ai popull.

Dhënia përparësi atij që është më i madh dhe anës së djathtë:

Nikoqiri duhet të ketë parasysh, që t’i

japë përparësi mysafirit më të shtyrë në moshë dhe me një përkujdesje më të veçantë, ngase Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* na ka inkurajuar për te. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* thotë: ***“Ai që nuk i mëshiron të vegjlit tanë dhe nuk i respekton të rriturit nuk është nga ne”.***

Lutja e mysafirit pas ushqimit për nikoqirin:

Prej Sunetit të Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur hante ushqim tek dikush bënte dua për ta. Kumtohet nga Enesi: “Se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* shkoi tek Sad ibën Ubadeh pasi solli bukë dhe vaj Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* hëngri dhe tha: ***“Bëfshin tek ju iftar agjëruesit. Ushqimin tuaj e hëngërshin të devotshmit dhe për ju bëfshin dua melaiket.”***¹² Disa dijetarë e kanë veçuar vetëm tek ai i cili bëhet iftar e shumica janë të mendimit se është e përgjithshme. Transmeton Abdullah ibën Busër, se babai i tij kishte përgatitur ushqim për Pejgamberin *sal-lallahu alejhi ue selem* e thirri atë dhe ai *sal-lallahu alejhi ue selem* iu përgjigj. Kur e kreu ushqimin tha: ***“O Zot fali ata, mëshiroji dhe begatoji në atë që i ke furnizuar.”***¹³

Të pëlqyerit e përcjelljes së mysafirit deri tek dera:

Ky është plotësimi i mirëpritjes dhe mirësjellja me mysafirin, që të ndihet rehat, deri sa të largohet nga shtëpia. Për këtë nuk kemi ndonjë hadith të prerë, por kemi shumë gjurmë nga të parët tanë. Shabiu ka thënë: “Nga plotësimi i vizitës së mysafirit është që ta përcjellësh deri tek dera dhe ta kapësh për supesh...”¹⁴ ■

(Shkëputur nga libri “Kitabul Adab” Fuad ibën Abdulaziz Shelhub)

¹¹ Fet’hul Kadir 4/341 .

¹² Muslimi 3003.

¹³ Ebu Davudi 3854. Saktësuar nga Imam Albani .

¹⁴ Muslimi 2042, Ahmedi 17220.

¹⁵ Adab Sherije 3/227.



LIDHJA E BUKUR E QUAJTUR: “MOTRA NË ISLAM”

HATIXHE XHONS

Lidhja e motrave në Islam është diçka shumë e veçantë. Nëse një motër afrohet në këtë lidhje si praktikuese fillestare, apo qoftë duke e zbatuar e plotësuar ndonjë urdhëresë si (mbulesën), motrat e saja në Islam e trajtojnë në atë mënyrë, saqë askush s'e ka bërë më parë, madje as familja e saj.

Çfarë e bën këtë lidhje aq të veçantë?

1. Ato i duan motrat e tyre në Islam vetëm për Hir të Allahut.

Nuk është me rëndësi se çfarë ngjyre lëkure ke, gjuhën që ti flet, statusi i familjes tënde, nëse jeni të pasur apo të varfër, në Islam të gjithë jemi të bashkuar si një familje e vetme. Besimi në Allah na ka bashkuar. **“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër...”** (Kuran 49: 10).

I Dërguari ynë, *sal-lallahu alejhi ue selem*

ka thënë: “Askush nga ju nuk do të arrijë kënaqësinë dhe ëmbëlsinë e besimit derisa të jetë Allahu dhe i Dërguari i tij më i dashur se vetja dhe çdo gjë tjetër, ta dojë një person vetëm për hir të Allahut pa asnjë arsye tjetër, dhe të urrej kthimin mbrapa në mohim ose mosbesim, ashtu siç urren të hidhet në zjarr.” (Buhariu dhe Muslimi).

2. Gjendja e dy vetave që duhen për hir të Allahut

Ekzistojnë shpërblime të mëdha për ata që duhen për hir të Allahut.

“Ku janë ata që e donin njëri- tjetrin për hir të Madhështisë Sime? Unë sot do t'i strehoj ata nën hijen Time, në këtë ditë kur nuk ka hije tjetër, veç hijes Sime.” (Muslimi)

I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem* thotë: “Një njeri shkoi të vizitonte vëllanë e tij në një fshat tjetër. Allahu dërgoi një engjell në rrugën nga do të kalonte. Kur ai kaloi pranë tij engjelli e pyeti: Ku po shkon?

Dua të shkoj të vizitoj një vëlla në këtë fshat, - u përgjigj ai. A ke ndonjë interes që po shkon? - vazhdoi engjëlli. -Jo, -tha ai. -Unë e dua atë për hir të Allahut, prandaj dua të shkoj ta vizitoj. "Unë jam meleku i Allahut. Jam dërguar tek ti për të të komunikuar, që Allahu të do, ashtu si e do atë për hir të Tij. -tha engjëlli." (Muslimi)

Po ashtu ne jemi të inkurajuar për t'i treguar njëri-tjetrit, për të nxitur dashurinë në lidhjet mes nesh. Transmetohet nga Enesi *radijallahu anhu*, që ka thënë se një njeri ishte tek Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe kalon aty një njeri tjetër, kurse ky që ishte tek Pejgamberi tha: *"O i Dërguar i Allahut, unë vërtet e dua këtë njeri."* Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* tha: *"A e ke njoftuar atë se e do?"* Tha: *"Jo."* Pejgamberi i tha: *"Njoftoje."* Ky e takon dhe i thotë: *"Unë të dua për hir të Allahut."* Ai i tha: *"Allahu të dashtë, që për hir të Tij më deshe."* (Ebu Davudi)

3. Efekti i Dashurisë për hir të Allahut në jetën e besimtares

Është e rëndësishme që ne të përshëndetemi në mënyrën e duhur sipas rregullave Islame. I Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *"Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, nuk do të hyni në Xhenet përderisa nuk besoni dhe nuk do të besoni përderisa nuk do ta doni njëri-tjetrin. A doni që t'ju këshilloj për diçka që nëse e praktikoni, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni përshëndetjen me *selam* mes jush". (Sahih Buhari)*

Dhe kur njeri prej nesh është i dëmtuar, i shtypur, apo duke vuajtur në një farë mënyre, ne të gjithë e ndjejmë atë dhimbje. *"Do të shikoni se besimtarët në dhembshurinë që kanë për njëri-tjetrin janë si puna e një trupi: nëse një pjesë e tij ndien dhimbje, pjesa tjetër e trupit vuan nga pagjumësia dhe ethet."*

4. Ajo nuk heq dorë, nuk e braktis motrën e saj

Ne nuk lejojmë që mospajtimet tona apo keqkuptimet të na mbajnë larg. Ne punojmë që t'i mbajmë fort lidhjet tona. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem* thotë: *"Nuk i lejohet besimtarit hidhërimi me vëllanë e tij më shumë se tri ditë, kur ata takohen dhe ia kthejnë njëri-tjetrit fytyrën, më i miri nga ata është ai që i pari i jep *selam* vëllait të vet". (Buhariu dhe Muslimi)* Dhe e gjitha çka na duhet neve për të përmirësuar në këtë lidhje është të përshëndetemi me përshëndetjen e paqes *"Es-Selamu Alejkum"* *"Paqja e Allahut qoftë mbi ju"*.

Ne gjithmonë duam më të mirën për njëra-tjetrën, po ashtu shmangemi nga dëmtimi i motrave tona në Islam. I Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *"Mos i bëni zili njëri-tjetrit, as mos e mashtroni njëri-tjetrin; mos e urreni njëri-tjetrin; mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, duke u hidhëruar; mos i ndërhyri njëri-tjetrit në shitblerje. Bëhuni, robër të Allahut, vëllezër të vërtetë. Muslimani është vëlla i muslimanit. Nuk i bën atij padrejtësi, nuk e dëmtton, nuk e tradhëton. Devotshmëria është këtu."* Tri herë tha duke bërë shenjë në gjoksin e tij. *"Një njeriu i del mjaft e keqja, nëse e nënçmon vëllanë e tij musliman. Çdo muslimani i janë të shenjta dhe të paprekshme patjetër jeta, pasuria dhe nderi i muslimanit tjetër". (Muslimi).*

Po ashtu porositemi të mos mbajmë mëri. I Dërguari ynë, Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *"Dyert e Xhenetit janë të hapura të Hënave e të Enjteve, dhe çdo rob (i Allahut), që nuk bën shirk është i falur, përveç një njeriu që ka në mes tij dhe vëllait të tij mëri e inat. Thuhet: "Prisni derisa të pajtohen, prisni derisa të pajtohen, prisni derisa të pajtohen."* (Muslimi).

5. Ajo fal, është toleruese ndaj motrës së vet

Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Fisnik

thotë për të devotshmit **“...e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”** (Kuran 3: 134).

6. Ajo takohet me motrat e veta me fytyrë të buzëqeshur

Profeti Muhamed *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Mos e nënvlerëso asnjë të mirë, qoftë dhe një buzëqeshje para vëllait tënd.”** (Muslimi).

7. Ajo është besnike dhe e sjellshme ndaj tyre

Ne duhet të përpiqemi të bëjmë më të mirën për të ndjekur shembujt nga i Dërguari ynë *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili ishte shëmbëlltyra më e mirë e mirësjelljes dhe e tolerancës. Enes ibën Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, shërbëtori i tij dhe shoqëruar i vazhdueshëm e përshkroi karakterin e tij fisnik në këtë mënyrë: **“I kam shërbyer të Dërguarit të Allahut, pagja e Allahut qoftë mbi të, 10 vite dhe ai kurrë nuk më ka thënë as “Uh!”. As nuk më ka thënë për çka do që kam bërë: ‘Pse e bërë këtë? As nuk më ka thënë për çka do që kam lënë: Pse e ke lënë këtë?’”** (Buhariu dhe Muslimi).

Duhet të përpiqemi të bëjmë më të mirën në sjelljen ndaj motrave tona.

Pejgamberi ynë *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Nuk hyn butësia në ndonjë gjë e që mos ta zbukurojë atë, dhe nuk largohet nga ndonjë gjë e që mos ta shëmtojë atë.”** (Muslimi).

8. Ajo nuk përgojon ndaj tyre.

Ne duhet të shmangemi rreptësisht nga shpifjet, thashethemet ndaj motrave tona në Islam. **“Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njeri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frike Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”** (Kuran 49: 12).

Pejgamberi ynë *sal-lallahu alejhi ue selem* ka paralajmëruar Muadh ibën Xhebelin, duke kapur gjuhën e tij e ka thënë: **“Ruaje këtë.”** I thashë: **“O Pejgamberi i Zotit, a thua edhe për këtë përgjegjës do të jemi?”** Ai tha: **“Të mos pastë nëna o Muadh! E çka tjetër i hedh njerëzit në Zjarr përveç gjuhët e tyre të këqija.”** (Tirmidhiu).

9. Ajo është bujare dhe i nderon motrat e veta

Duhet te jemi gjithmonë të etur për të ndarë atë që e kemi, pa marrë parasysh sa e vogël mund të jetë. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Përhapeni selamin në mesin tuaj, jepuni ushqim njerëzve, mbani lidhjet familjare, dhe, kur njerëzit të flenë, ju falni namaz , ngase kështu hyni në Xhenet me paqe.”** (Ahmedi).

Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* gjithashtu ka thënë: **“Në Xhenet ka dhoma në të cilat ana e jashtme e tyre shihet nga brenda dhe ana e brendshme e tyre shihet nga jashtë. Këto i ka përgatitur Allahu për atë, i cili i ushqen nevojtarët, flet mirë, agjëron shpesh dhe falet natën, kur të tjerët flenë.”** (Ahmedi).

10. Ajo lutet në mungesë të motrave të veta

Dhe kur ndonjë motër e dashur, apo ndonjë mike është larg prej nesh ne lutemi për te.

I Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Lutja më e shpejtë për t’u përgjigjur është lutja e një njeriu që lutet për vëllanë e vet në mungesë të tij.”** (Buhariu)

Ju nuk jeni besimtare të vërteta deri sa të doni për motrën tuaj atë që doni për veten. Ne duam për motrat tona, që të jenë në Xhenet, aq shumë sa duam për veten tonë, që të jemi atje. Ne bëjmë përpjekje t’i lutemi Allahut së bashku krah për krah në këtë lidhje të bukur të quajtur motra në Islam. ■

Përshtati nga anglishtja: Burbuqe R.

ËSHTË ÇËSHTJE KOHE

Si femra muslimane ne nuk mund të lejojmë gjithsesi, që përgjegjësitë dhe detyrat shtëpiake si grua, nënë, e madje edhe si studente ose profesioniste, të na ndalojnë neve nga koha e adhurimit të Allahut, në kohën e duhur dhe me qëllime të drejta

NASIHA AHMED

Qysh nga fillimi është dikush tjetër që ka kontrolluar kohën tënde, ose të qenit tënd në kohë. Kur ishim të vogla, prindërit tonë kanë vendosur, se kur do të shkojmë në shkollë dhe sa ishim herët apo vonë. Ata na ndihmuan të vishemi dhe të

bëhemi gati dhe të ishim nën kontrollin e tyre. Pastaj, si u rritëm, fituam diçka nga vetë pavarësia jonë, por pastaj shumë femra martohen dhe më pas kontrolli i tyre rreth kohës së tyre përsëri nuk e kanë nën kontrollin e vet. Orët e ditës nuk janë në domosdoshmërinë e tyre. Qoftë kur duhet të paraqitesh në punë në kohën e caktuar, duke dërguar fëmijët në shkollë

në një kohë të caktuar, apo edhe të përgatitet mëngjesi për vete dhe për burrin para se ti dhe ai të ikni për në punë, e gjitha kjo kërkon të bësh diçka në një kohë të caktuar. Kjo kërkon përpikëri në oraret.

Një nga shprehitë më të vështira në jetë për të zotëruar duket të jetë përpikëria. Shumë prej nesh mund të arsyetojnë, se jeta i ngec mënyrat tona, punën, martesën dhe fëmijët, por kur është fjala për trajtimin e gjithë kësaj në kohën e duhur, disa nga ne dështojmë. Shumica prej nesh si fëmijë nuk e harrojmë vonesën për në shkollë, duke vrapuar nëpër shtëpitë tona, duke kërkuar detyrat e shtëpisë ose këpucët. Duke pyetur nënat tona ku e kemi lënë xhakëtën. Përse ishim gjithmonë vonë? Pastaj u rritëm dhe shkuam në kolegji, ose u punësuam, akoma mbetëm pre e kohës, ku na kontrollohet ora. Ose do të rrëshqasim drejt bankave tona të kolegjit posa profesori të fillojë ligjëratën, ose pasi të shpërndajë fletët e provimit me shkrim.

Pse shumica prej nesh jemi zakonisht vonë, jo vetëm për punë ose shkollë, por në shumë aspekte të tjera të jetës. Më e rëndësishmja që si gra të shtëpive tona, çfarë mund të bëjmë për familjet tona dhe për veten tonë për të thyer këtë cikël të zvarritjes së vazhdueshme dhe vonesës së përhershme?

Praktikimi i përpikërisë në pothuajse çdo gjë.

Në çdo gjë që bëjmë nga momenti që rritemi ne duhet të praktikojmë përpikërinë. Prioritetet e tona duhet të përfshijnë të qenit në kohë dhe besueshmërinë në të gjitha aspektet e aktiviteteve tona të përditshme.

Përbushja e përgjegjësisë me rregullsi

Kjo është fusha më e rëndomtë e zvarritjes, ku në të cilën shumica prej nesh janë fajtorë të kësaj.

Ndonjëherë disa nga ne gjatë viteve formojmë një qëndrim: “Do ta bëj më vonë” dhe fillojmë t’i zhagisim detyrat tona, nga ato të voglat deri tek ato të mëdhatë. Ne fillojmë ta shtyjmë lavanderinë derisa të mblidhen dhe derdhen nga legeni i kuzhinës, lejojmë që enët të grumbullohen në lavaman dhe pastaj kemi ndjenjën, se do të fundosen ashtu si i shtyjmë me bërnyll thellë disa ditë më vonë në ujin e yndyrshëm të enëve. Jemi vonë një natë para provimit të rëndësishëm, sepse e kemi shtyrë të mësojmë deri në momentin e fundit; në fakt shtyjmë çdo gjë dhe gjithçka – të gjitha porositë, punët, detyrat dhe përgjegjësitë. Por a duhet?

Jo, më mirë duhet të mundohemi t’i përbushim detyrat tona sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo është gjëja më e mirë për ne në të gjitha drejtimet.

1. Ne mund t’i realizojmë ato nevoja që duhet të bëhen dhe të marrim përsipër detyrime tona të tjera.

2. Ne mund të bëjmë një punë më të mirë duke i dhënë vetes kohë të mjaftueshme.

3. Ne mund t’i japim një shembull të mirë familjeve tona, duke u treguar atyre se i marrim përgjegjësitë tona seriozisht. Nëse ata shohin se ne i shtyjmë, mund ta marrin si neglizhencë.

4. Përpikëria çon drejt parimësisë në veprim.

Si gra shtëpiake ekzistojnë shumë përgjegjësi, që qëndrojnë mbi supet tona,

dhe nëse ne largojmë zvarritjet, ne parandalojmë atë barrë të madhe të ndjenjës “së ngecjes mbrapa” – në detyrat e shtëpisë, në shkollë, në punën tonë, në çdo gjë që i bie të jetë tepër shumë për ne.

Përpikëria në adhurim

Si femra muslimane ne nuk mund të lejojmë gjithsesi, që përgjegjësitë dhe detyrat shtëpiake si grua, nënë, e madje edhe si studente ose profesioniste, të na ndalojnë neve nga koha e adhurimit të Allahut, në kohën e duhur dhe me qëllime të drejta. Kjo posaçërisht i referohet namazit. Kryerja e namazit në kohën e caktuar dhe me bindje është thelbësore për të jetuar jetën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të japim një shembull më të mirë për familjet e tona.

Një nga gjërat e para që bëjmë në mëngjes dhe pa dyshim aktiviteti më i rëndësishëm i ditës është namazi, që jo vetëm që përfiton nga përpikëria, por edhe është i detyrueshëm. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* u pyet: Cila vepër është më e dashur për Allahun? - dhe ai iu përgjigj: “*Namazi në kohën e vet*”.

Përpikëria në kryerjen e namazit do të thotë se ne i lëmë enët (e thënë kjo jo tekstualisht) për ta kryer sa është koha, sigurohu ta bësh atë para se t'i marrim fëmijët nga shkolla, nëse është e mundur. Kryeje namazin në zyrë, nëse është e mundur, kryeje në shkollë; kurdo që të jetë koha e duhur e namazit ne duhet të ngrihemi që ta kryejmë atë. Dhe namazi nuk është forma e vetme e adhurimit, që përfiton nga përpikëria: duaja është një formë e rëndësishme e adhurimit, ku përpikëria dhe koha e caktuar janë të

“...Marrëdhëniet tona me bashkëshortët, prindërit, fëmijët, shoqet tona, apo me këdo që ka çfarëdo lloj domethënie për ne, kërkon përpjekje...”

pandashme. Forma të duasë, si istigfari dhe të tjera për falënderim dhe teube duhet të bëhen në kohën e duhur për të pasur përfitime më të mëdha. Ngjashëm është pagesa e zeqatat, një formë tjetër adhurimi për të cilën koha mund të thotë shumë, sidomos për ata që mund të ketë dobi bamirësia. Për shembull, kur dhurojmë para në një mbledhje fondesh për një qëllim të caktuar, shuma e parave që japim në atë kohë të caktuar është e domosdoshme për atë qëllim specifik. Duhet të bëjmë plane për të dhënë dhe dhuruar, por nëse nuk e bëjmë kur është nevoja, atëherë nuk do të ketë vlerë. Kryesorja është të bëhet ajo dhe të bëhet saktësisht kur gjeneron të mira më të mëdha. Për ata që janë në nevojë koha është e rëndësishme.

Besueshmëria në lidhje

Koha është një gjë shumë e rëndësishme për mbajtjen e lidhjeve, si dhe për adhurim. Megjithatë për ca arsye të çuditshme njerëzit me tendencë i marrin lidhjet si të mirëqena. Ne i ngremë ato lidhje dhe pastaj pretendojmë se ato do të zgjasin; se ato nuk kërkojnë pak a shumë punë për t'i mirëmbajtur. Si femra, duhet


të dimë se kjo nuk është e vërtetë dhe se për të mbajtur lidhje të shëndosha dhe të lumtura me të gjithë ata që janë afër nesh, ne duhet të punojmë me ato rregullisht dhe vazhdimisht. Kjo do të thotë, se duhet të jemi një hap para krizave. Femrat e dinë mirë, se emocionet tallaziten dhe mund të hyjnë në mes të dy palëve. Prandaj është e domosdoshme, që duhet të jemi të qëndrueshme në përpjekjet tona për të mbajtur lidhjet tona në atë masë që dëshirojmë. Me fjalë të tjera, marrëdhëniet tona me bashkëshortët, prindërit, fëmijët, shoqet tona, apo me këdo që ka çfarëdo lloj domethënie për ne, kërkon përpjekje. Në mënyrë që të sigurohemi se këto lidhje mbeten të shëndosha, duhet të jemi të përpikta në trajtimin e çështjeve, që mund të dalin. Mendoje mosmarrëveshjen tënde domethënëse më të fundit, që ke pasur me bashkëshortin, prindin ose fëmijën tënd. Në qoftë se mund ta keni trajtuar atë menjëherë, a keni mundur ta eliminoni problemin, ose ta keni zvogëluar problemin në mënyrë të konsiderueshme? Ti dhe një shoqe keni një mosmarrëveshje të vogël. Ndiheh pak e mërzitur dhe ke vendosur se është më mirë mos të përsëritet prapë, por sigurisht akoma ndihesh e mërzitur për situatën. Heziton ta trajtosh situatën menjëherë, sepse ndihesh se ndoshta 'lahet' dhe kjo do të jetë e falur dhe e harruar shumë shpejt. Megjithatë të gjithë e dimë, se shumica e femrave nuk funksionojnë kështu. Shumica e njerëzve kanë kujtesë shumë të fortë për të harruar ndonjë gjë, kështu që duhet të punohet dhe bisedohet me ta derisa të arrihet një falje e vërtetë.

Ndonjëherë femrat e kanë si tendencë

t'i injorjnë situatat e ndodhura, që janë të mbushura emocionalisht; ne jemi në mëdyshje për t'u marrë me çështjet që ndikojnë negativisht marrëdhëniet tona. Sidoqoftë kjo është e rrezikshme dhe që mund ta tejzgjasë pashmangshëm dhe një problem të vogël ta përkeqësojë. Si në rastin kur ka shumë situata zhagjitja nuk është ideja më e mirë. Në të kundërtën, përpikëria është mënyra më e mirë për t'i dhënë fund krizave afatgjate. Kjo është njëra nga arsyet, që Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka dhënë aq shumë këshilla kundër prishjes së lidhjeve. Për shembull, ai thotë: *"Nuk duhet të ketë prishje të lidhjeve, as të largoheni njëri prej tjetrit, as ta urreni njëri-tjetrin. Bëhuni vëllezër (dhe motra), siç u ka urdhëruar Allahu."* (Muslimi). Zemërimi mund ta godasë gruan (dhe natyrisht edhe burrin) në momente dobësie emocionale, por Islami e lejon tri ditë këtë gjë, si një gjatësi e lejuar kohore gjatë së cilës zemërimi mund të largohet. Është e vështirë në dukje, por në qoftë se kemi të bëjmë me punët tona, adhurimin tonë personal, ose marrëdhëniet tona, më e mira është të merremi me situatën sa më shpejt të jetë e mundur dhe të ndalohet problemi para se të bëhet vonë e të përkeqësohet. ■

nga anglishtja: Drita Maliqi

MOS NA PARAGJYKONI, PO BISEDONI ME NE!



Përmes kësaj duam të themi, se nëse ne bëjmë vizita tek të afërmit, ose ata vijnë tek ne dhe me disa nuk përshëndetemi për dore, ose nuk i heqim mbulesat nga koka, ose ndahemi me gjini në dhoma të ndejës, nuk ka askush të drejtë të na fyejë e të na paragjykojë, në lidhje me dispozitat e besimit të cilave ne i takojmë

SHKRUAN: VALBONA KELMENDI

Në vitet e para të profecisë së Muhamedit, *Nalejhi salatu ue selam*, madje në tërë periudhën e tij 13 vjeçare të Mekës, metoda e bisedës ka qenë në krye të metodave komunikuese fetare që përdori ai. Edhe në vitet në vijim biseda vazhdoi të ishte një nga metodat orientuese më me ndikim të tij.

Në këtë trajtim tonin ne nuk kemi si qëllim bisedën-leksion, por bashkëbisedimin siç i ka hije këtij fillim shekulli, pa marrë parasysh se cilit besim i takon, ose s'i takon fare, me qëllim që t'i mënjanojmë dhe t'i zhdukim paragjykimet, të cilat po zënë vend me pa të drejtë ndaj femrave besimtare muslimane në veçanti e fetarëve muslimanë

në përgjithësi.

Brenda kësaj shoqërie në të cilën po jetojmë e zhvillohemi, duke u nisur edhe nga familjarët, pse marrin të drejtën për të paragjykuar ndaj një besimtareje me mbulesë, pa biseduar me askënd e pa lexuar apo studiuar ndonjë libër rreth dispozitave të saj, duke thënë se ajo është e prapambetur, ose e paintegruar, e paarsimuar, e lënë pas dore, e nëpërkëmbur, e mbuluar me para etj., etj.

Sapo që njeriu i përgjegjshëm të vërtetojë besimin e tij, të cilit ai i takon, në këtë rast ata të cilët e vërtetojnë besimin islam detyrohen për ruajtjen e lidhjeve fafeshnore. Në sajë të kësaj një nga të mirat më të vyera me të cilat jemi favorizuar është padyshim jeta jonë. Ndërsa për të mos lejuar që të jemi pre' e punëve tërheqëse të kësaj jete kalimtare,

“...Është gabim që dikush të mendojë se, për shembull, veshja dhe mbulimi i grave sipas urdhrit hyjnor po i thyen rregullat etike të shoqërisë...”

drejtë të përqeshë fjalën e Tij dhe Sunetin e Profetit Muhamed, *alejhi salatu ue selam*. Duhet ditur se besimi nuk është diçka e tepërt, që mund të hidhet kur të kërkohet ose kur të duash. Ai është themeli i ekzistencës shpirtërore, madje duhet ditur, se nëse njeriu është zotëria i krijesave të tjera, nuk është zotëria i njeriut. Përmes kësaj duam të themi, se nëse ne bëjmë vizita tek të afërmit, ose ata vijnë tek ne dhe me disa nuk përshëndetemi për dore, ose nuk i heqim mbulesat nga koka, ose ndahemi me gjini në dhoma të ndejës, nuk ka askush të drejtë të na fyejë e të na paragjykojë, në lidhje me dispozitat e besimit të cilave ne i takojmë. Të tregojmë një gjë, pse ekziston turpi tek ne dhe nuk revanshohemi me të njëjtën gjuhë sikurse po privohemi, s’do të thotë se ne jemi injorantë ose të ligj. Përderisa ekziston modeli dhe dëshira e lirë e të jetuarit e vepruarit, edhe ne kemi të drejtat tona, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët, ose të paktën të na lejnë të qetë shpirtërisht.

Sa i përket pjesës tjetër të jetës, si dasmave dhe ceremonive mortore, besimi Islam nuk është i lidhur ndaj zakoneve, traditave dhe veseve. Ngaqë Islami është fe, që do t’u flasë njerëzve për sa të jetë bota, nuk është përzier në zakonet dhe traditat përkatëse të kombeve. Kështu që nga kjo anë i sigurohet hyrje me lehtësi në Islam çdo kombi, populli pavarësisht nga pozicioni

sikur po kërkohen vazhdimisht organizime, takime e vizita të njëpasnjëshme për të mundur që të ruhen lidhjet me farefisën. Por jo rrallë po janë të rënda e shumë privuese për besimtarët e besimtare të besimit islam.

Kur e themi këtë padyshim që kemi një arsye dhe kemi shumë të drejtë të ngremë zërin për vetëdijesimin e formimit të karaktereve për ata njerëz, të cilët vërtetë po dinë të jenë shumë të pamatur e shumë të papjekur në lidhje me parimet dhe të drejtat personale të besimtarëve muslimanë.

Paraprakisht po rikujtojmë një ajet, i cili thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”** Dharijat: 56.

Me këtë detyrë të pranuar ne dallohemi nga kafshët, sepse epërsia e njeriut qëndron te detyra e zemrës. Por edhe për këtë Zoti ka dhënë liri, porse askujt nuk i ka dhënë lirinë, që ta fyejë tjetrin e sidomos për të drejtat e tij fetare. Aq më pak, askujt s’i ka dhënë të

gjeografik dhe raca që i takon.

Në sajë të kësaj të mire është gabim që dikush të mendojë se, për shembull, veshja dhe mbulimi i grave sipas urdhrit hyjnor po i thyen rregullat etike të shoqërisë, nëse ajo nuk prezanton në dasmën e vëllait, ose nipit apo mbesës së saj.

Është shumë jo-njerëzore, nëse tepruhet me marrje kompetencash nga ata të cilët janë disa rrathë më larg nga afërsia familjare dhe me paditurinë që kanë fyejnë besimtarët dhe fusin përçarje e konflikte familjare.

Karshi dasmave në jetë është edhe vdekja e të afërmeve. Por njerëzit, të cilët janë të prirë e të edukuar, që të shkaktojnë vetëm dhimbje dhe lëndime tek të tjerët, besimtareve ua bëjnë edhe më të rëndë gjendjen, duke tentuar me çdo kusht që të zbatohen traditat e zakonet, pa marrë parasysh, se a janë në kundërshtim me fenë apo jo. Presionet shtohen e bëhen nga më të ndryshmet. Sipas tyre, nëse nuk veprohet sipas traditave dhe zakoneve familjari i vdekur në familjen e tij nuk ka gëzuar dashuri e respekt, qoftë edhe nëse është babai ose nëna e fëmijëve besimtarë praktikues.

Sa për ilustrim, një shembull praktik: me çfarë logjike mund të pajtohem, se një kushëri mund të jetë më i dashur, ose më i afërt sesa prindërit për fëmijët e tyre?!... Vërtetë këto janë privime të padrejta, të cilat mund t'ia shkaktojë njeriu njeriut, por fatbardhësisht besimtarët i mban ajeti kuranor, i cili thotë: ***“E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së Allahut, duke mos pasur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm. Ai që shtrembëron qafën (në shenjë mendjemadhësie), e përpiqet t'i humbë njerëzit nga rruga e Allahut. Atij do t'i takojë poshtërimi në këtë jetë, ndërsa në ditën e kiametit atij do t'ia veshim dënimin e djegies (të zjarrit).”*** Haxh: 8-9.

“Po ndodhemi nën presionin e sulmeve, që na vijnë, edhe nga jobesimtarët, edhe nga disa të ashtuquajtur besimtarë...”

Botën në të cilën jetojmë sot mund t'ia përngajmë një fushe lufte, ku përplasen shumë ideologji. Shumë pikëpamje të drejta apo të gabuara, qoftë edhe perverse, devijuese, përpiqen ta bëjnë të pranueshme vetveten. Muslimanët në përgjithësi e femrat muslimane në veçanti, duam apo s'duam ndodhemi brenda kësaj lufte. Po ndodhemi nën presionin e sulmeve, që na vijnë, edhe nga jobesimtarët, edhe nga disa të ashtuquajtur besimtarë.

Këtu ndoshta nuk do të jetë e mundur të tregojmë gjerë e gjatë, se çfarë po përjetojmë dhe se nga çfarë po privohemi, e as të tregojmë gjerë e gjatë se ç'na duhet të bëjmë. Por mund të themi si idenë kryesore e përmbyllëse të këtij trajtimi, se neve na duhet një bindje e fortë orientuese, e cila na shpie kah përjetësia. Kjo bindje para çdo gjëje tjetër do të fuqizojë lidhjet midis neve dhe Zotit dhe vetëm kjo do të na bëjë të jemi stabilë dhe të qëndrueshëm, pse jo edhe triumfues para çdo furtune, madje edhe para atyre banale, të cilat po na shfaqen çdo ditë. E sa për inkurajim duhet ta kujtojmë gjithnjë ajetin që thotë: ***“Ti (Muhamed) **thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai e di më së miri për të udhëzuarit.”***** Nahl:125.

Për fund lutemi që Allahu të na falë neve, të na udhëzojë neve e familjet tona, si dhe të gjithë popullin tonë në përgjithësi dhe të na mbrojë nga zjarri ndëshkues e përvëlues i xhehenemit. Amin! ■



LIDHJA FAREFISNORE, URË MES FAMILJEVE

Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”*** Nisa 1

SHKRUAN: ALI SHABANI

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar” këto fjalë u drejtohen të gjithë njerëzve për t'i orientuar nga Krijuesi i tyre, i Cili i ***“ka krijuar prej një vete***

(njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra”. Kjo është një përgjigje për ata që u qarkullon vazhdimisht dilema në kokë për prejardhjen e tyre. Njëkohësisht ua bën me dije, se ky njerëzim që buron nga prindër të përbashkët dhe ka një lidhje farefisnore,

ka origjinë të njëjtë. Po ashtu ajeti e bën të qartë, se familja është bazamenti i njerëzimit. Ka filluar nga një familje, e pastaj janë shpërndarë nëpër botë. Mirëpo ajo që kërkohet për të qenë familje, e pastaj shoqëri shembullore është devotshmëria ndaj Allahut të Madhëruar, të jetojmë nën urdhrat e Tij, nën një sistem dhe rregull që është i evidentuar me ligjin e Allahut të Gjithëdijshëm, në fenë e Tij të vetme të pranuar, fenë islame. Kjo shihet tek urdhri i përsëritur i Allahut në vetë ajetin ***“Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përбетoheni”*** e me këtë devocion ***“ruajeni farefisn (akraballëkun)”***, dhe të gjithë këtë Allahu e përfundon me kujdesin ndaj mbikëqyrjes së Tij ***“se Allahu është mbikëqyrës mbi ju”***¹

Allahu i Madhëruar u thotë krijesave të Tij, duke i urdhëruar të jenë të devotshëm, që vetëm Atij t'i nënshtrohen dhe mos t'i shoqërojnë Atij askënd. Pastaj ua tërheq vërejtjen për fuqinë e Tij, me të cilën i ka krijuar prej një vetes, e ai është Ademi *alejhi selam* ***“...dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj”***, e ajo është Hava *alejha selam*, e cila është e krijuar nga brinja e majtë nga mbrapa gjersa ai flinte. Kur është zgjuar ka shikuar kah ajo dhe i ka pëlqyer. Ai ishte i kënaqur me te dhe po ashtu ajo ishte e kënaqur me të. Në hadithin e vërtetë qëndron: “Gruaja është krijuar nga brinja, a pjesa më e shtrembët e brinjës është pjesa më e lartë. Nëse tenton ta drejtosh, do ta thyesh, e nëse dëshiron të kesh dobi nga ajo, do të kesh

“...Gruaja është krijuar nga brinja, a pjesa më e shtrembët e brinjës është pjesa më e lartë. Nëse tenton ta drejtosh, do ta thyesh, e nëse dëshiron të kesh dobi nga ajo, do të kesh edhe duke qenë ajo e shtrembët...”

edhe duke qenë ajo e shtrembët.”

“...e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra...”, d.m.th., nga ata të dy Ademi dhe Havaja ka krijuar shumë burra dhe gra dhe i ka shpërndarë nëpër vende të ndryshme të botës, me lloje të ndryshme, me cilësi të ndryshme, me raca dhe gjuhë të ndryshme, që pastaj Atij t'i kthehen me ringjallje.

Pastaj thotë: ***“Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisn (akraballëkun)”***. Dahaku ka thënë: Kini frikë Allahun ndaj të Cilit keni detyrim dhe ruani lidhjet farefisnore dhe mos i këputni, por përforcojini dhe mirëmbajini.

“se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.” Ai i mbikëqyr të gjitha krijesat dhe i përcjell hollësisht gjendjet e tyre, ashtu siç ka thënë në ajetin tjetër: ***“...e Allahu është dëshmitar i çdo sendi.”*** Buruxh 9. Në hadithin sahih qëndron: ***“Adhuroje***

¹Fi Dhilalil-Kuran të Sejdi Kutubit, v. I, fq. 573.

²Tejsirul-Aljil-Kadir lihtisar tefsir Ibn Kethir të Nesib Rifai, v. I, fq. 349, 350.

³El-Xhamiu liakamil-Kuran të Kurtubiut v. 5, fq. 12

Allahun ashtu sikurse e sheh Atë, edhe pse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty.” Mutefekun alejhi.

Ky është urdhër për t’u përkujdesur ndaj mbikëqyrjes së Mbikëqyrësit. Për këtë edhe Allahu i Madhëruar e ka përmendur se origjina e krijimit prej një babai dhe një nëne është në atë për të qenë i butë njëri ndaj tjetrit, të mirëtrajtohen mes veti, i forti ta ndihmojë të dobëtin etj. Në Sahihun e Muslimit qëndron nga Xherir ibën Abdullah El Bexheli, se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur kanë ardhur një grup nga Madari me rroba të grisura lakuriq, u drejtohet sahabëve me një fjalim pas namazit të drekës dhe u tha: **“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu)”** deri në fund të ajetit, e pastaj tha: **“O ju që besuat, kini parasysh frikën ndaj Allahut dhe le të shikojë njeriu, se çka ka bërë për nesër, dhe kini frikë Allahun, e s’ka dyshim se Allahu është që e di në detaje atë që ju punoni!”** Hashër 18. Pastaj i inkurajoi në lëmoshë dhe tha (përcjellësi i hadithit): Njëri dha lëmoshë nga dinarët e tij, ndërsa tjetri nga dërrhemët, tjetri një okë me drith, e tjetri një okë me hurma.²

Kurtubiu, në tefsirin e tij në lidhje me ajetin **“...ruajeni fafesisin** (akraballëkun)”, thotë: Dijetarët janë në konsensus, se mbajtja e lidhjes fafesisnore është vaxhib (detyrim) dhe shkaputja e asaj lidhje është haram (e ndaluar). Është i verifikuar hadithi, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* i ka thënë Esmasë *radijallahu anha* e cila e kishte pyetur: **A të mbaj lidhje me nënën time?- Po mbaj lidhjet me nënën tënde.- E ka urdhëruar t’i mbajë lidhjet me nënën e saj, duke qenë ajo jobesimtare.**

“...E kishte pyetur: A të mbaj lidhje me nënën time?- Po mbaj lidhjet me nënën tënde.- E ka urdhëruar t’i mbajë lidhjet me nënën e saj, duke qenë ajo jobesimtare...”

(Ebu Davudi 2/127 dhe Ahmed i në Musned 6/344, 347) ³.

Shtojcë: Një sociolog gjerman ka bërë një evidencë të një statistike sociale dhe vjen në përfundimin, se ardhmëria i takon Islamit. Edhe pasi i është bërë shantazh nga bashkëpunëtorët e tij, ai vazhdoi të pohojë atë që e ka studiuar me vite. Ajo ishte se ai kishte bërë krahasimin e shoqërisë islame me atë krishtere dhe duke parë se familjet në shoqërinë islame janë më të suksesshme, i kushtojnë rëndësi lidhjes fafesisnore, ndërsa në shoqërinë e krishtere janë të dështuara dhe nuk i kushtojnë rëndësi lidhjes fafesisnore, por edhe prejardhjen e tyre nuk e dinë të saktë. E lusim Allahun Fuqiptotë të na i mbrojnë nderin dhe familjen, Ai i dëgjon lutjet e robërve të Tij. Amin. ■



Na përcillet nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, të ketë thënë: “Erdhi një njeri te Profeti i Allahut, sal-lAllahu alejhi ue selem, dhe e pyeti: O i Dërguar i Zotit, kë detyrohem më shumë të respektoj (të sillem mirë me të)? Profeti i tha: “Nënë tënde”, pyetësi tha: Po pastaj? - “Nënë tënde”, po pastaj? “Prapë tha nënën tënde” po pastaj? (në të katërtën herë tha) Babanë tënd”.

TRI HISE NËNËN E NJË BABANË

LULZIM MEHMET SUSURI

Zinxhiri i hadithit: Shënon Buhariu, nr. 5971 dhe Muslimi, nr. 2548 që të dy nga sahabiu i nderuar Ebu Hurejre, Allahu

qoftë i kënaqur me të!

Komentimi i hadithit: Ky hadith është hadithi bazë, që tregon rëndësinë dhe përparësinë e respektimit të prindërve e sidomos nënës. Atij i bashkëngjitet në

rëndësi edhe hadithi tjetër në të cilin përmendet, se një njeri erdhi tek i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe i tregoi se kishte ardhur për të kërkuar leje që t'i bashkohej në luftë (xhihad), mirëpo Profeti e pyeti se a i kishte prindërit gjallë, e pasi mori përgjigje pozitive i tha: “Atëherë bëj luftë (xhihad) duke u kujdesur për ta.” shënon Buhariu: 3004 dhe Muslimi nr. 2549.

Këta dy hadithe janë më të njohurit rreth respektimit të prindërve. I fundit flet në përgjithësi për respektin e tyre, ndërsa i pari tregon përkujdesjen ndaj nënës duke e dalluar me epërsi trefishe ndaj babait.

Kush mund të jetë pyetësi? Në një transmetim të përmendur nga Muavije ibën Hajdeh (e jo nga Ebu Hurejre) përmendet se ai ishte vetë pyetësi i Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*.¹ Fjala “respektim” e cila përmendet në pyetjen e shtruar Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka si qëllim çdo gjë të mirë të cilën fëmija e ka detyrim karshi prindërve. Në të nuk futet vetëm respekti me gojë ose ai fizik, siç mund ta kuptojë ndokush. Ky respekt nuk ndalet vetëm me kaq, e për fat të keq dikush mendon se vetëm fjala e mirë i mjafton prindit. Në fjalën “respekt” hyjnë fjalët e mira, punët e mira, lutjet, kujdesi maksimal, ushqimi, veshmbathja etj., pra çdo gjë e cila është e mirë dhe e dobishme. Ai duhet dëgjuar në çdo gjë përveç nëse urdhri i prindërve është në kundërshtim me urdhrat e Islamit, në këtë rast nuk kryhet ky urdhër.

-Nuk duhet harruar fakti, se në të gjitha transmetimet e këtij hadithi ceket se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*,

“...Fillimisht ajo e bart në barkun e saj; së dyti e lind e së treti e ushqen me qumështin e gjirit të saj. Këto janë tri realitete me të cilat merret vetëm gruaja, kurse punët e tjera mund t'i bëjë edhe burri...”

respektin ndaj nënës e përsëriti tri herë e pastaj së katërti e përmendi atë ndaj babait (edhe pse në disa hadithe jo edhe aq të forta në zinxhirë transmetimit sa këto që po i përmendim respekti ndaj nënës ceket dy herë, por këto hadithe dijetarët nuk i kanë vlerësuar sa hadithet tona që i kemi bazë në këtë temë.).

Përse nëna të respektohet tri herë e babai një? Dijetarët e komentojnë këtë gjë me faktin, se nëna është personi kryesor, i cili merret me fëmijën. Fillimisht ajo e bart në barkun e saj; së dyti e lind e së treti e ushqen me qumështin e gjirit të saj. Këto janë tri realitete me të cilat merret vetëm gruaja, kurse punët e tjera mund t'i bëjë edhe burri. Pra, ai mund të ndihmojë në rritje, edukim, qëndrim pa gjumë natën kur foshnja qan etj., kurse në tri të parat nuk mund të përzihet, edhe pse zakonisht edhe gjërat e tjera që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj fëmijës përgjegjësia kryesore i takon dhe e bartin gratë dhe të rrallë janë rastet kur babai kujdeset më

¹ Transmetim që e shënon imam Buhariu në librin e tij “Edebul mufred” Ebu Davudi, Tirmidhiu etj. (Shih Fet-hul bari tek komenti i hadithit të lartpërmendur)

shumë se nëna për foshnjën e tij gjatë etapave të rritjes. Këto tri arsye janë shkaku që fëmija duhet të kujdeset tri herë për nënën e një për babanë. Kjo gjë që përmendëm është e spikatur edhe në Kuran:

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh.” Lukman, 14.

Kjo përparësi e nënës vjen në pah, atëherë kur të dy prindërit kërkojnë diçka dhe njeriu nuk di kujt t’i japë përparësi. Mirëpo nëse fëmija ka mundësi t’i respektojë të dy prindërit, atëherë i respekton ata e nëse ndodh që nevoja e tyre të jetë e menjëhershme, atëherë themi se i jepet përparësi nënës ndaj babait.

Disa dijetarë kanë bërë një koment më të thukët në këtë pikë, duke thënë se mëshira ndaj nënës duhet të jetë më e madhe, kurse madhështia dhe krenaria e babait duhet të jetë më e madhe. Pra, ata thonë se nëse baba urdhëron diçka që nëna ia ndalon djalit të saj, atëherë duhet respektuar babai, sepse ai e ka në përgjegjësinë e tij urdhërimit e familjes dhe si i tillë duhet dëgjuar fjala e tij, ndërsa në anën tjetër thonë se dhembshuria dhe sjellja e butë me nënën duhet të jetë tri herë më e madhe se me babanë. Nëse nëna sëmuret atëherë dhimbja për të duhet të jetë tri herë më e madhe se për babanë. Këta dijetarë e ndajnë kështu respektin prej urdhërimit, duke ia dhënë nënës përparësinë në respekt dhe mëshirë, kurse babait në kryerjen e urdhrave të tij. Sido që të jetë themi se në përgjithësi duke mos hyrë në detaje nëna në shpirtin e fëmijës duhet të

“Disa dijetarë e preferojnë t’i jepet përparësi mirësjelljes ndaj fëmijëve para atyre të gjyshërve, sidomos nëse fëmijët janë të vegjël ...”

jetë tri herë më e madhe se sa babai i tij, dhe mirësjellja ndaj saj, dhe dhënia përparësi është e vërtetuar me fjalët profetike, kurse kjo ndarje mund të jetë e mirë por prapë mbetet e paargumentuar qartë sikur e para.

Gruaja i jep përparësi respektit ndaj burrit apo nënës?

Femra i jep përparësi respektit të nënës deri para martesës e pas martesës respekti numër një i takon burrit e pastaj nënës. Kjo që përmendëm ceket në hadithin e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, të shënuar tek Ahmedi dhe Nesaiu, në të cilin Aisheja e pyet Profetin, duke i thënë: “O i Dërguar i Zotit, kush ka të drejta më shumë tek gruaja?- Profeti tha: “Burri i saj”,- Po tek mashkulli?- pyeti Aisheja. Ai iu përgjigj: “Nëna e tij”.- (Shih: Fet’hul bari tek komenti i këtij hadihi).

Kujt i takon fëmija nëse prindërit ndahen?

Përmendëm se fëmija duhet të respektojë më shumë nënën se babanë, mirëpo kur vjen në pyetje shkurorëzimi i prindërve, atëherë nëse nëna martohet fëmija i takon babait, edhe pse respekti ndaj nënës është më i madh.

Një ditë shkoi një grua tek Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, dhe i tha: O i Dërguar i Zotit, për djalin tim barku im ishte shtrat, gjiri ushqim, prehri qetësim, kurse babai i tij më ka shkurorëzuar dhe

dëshiron ta marrë atë nga unë. Profeti i tha: *“Ti ke të drejtë ta mbash fëmijën tënde më shumë se burri yt, nëse nuk martohesh.”* (Ebu Davudi nr. 2276 dhe Hakimi me sened të mirë)

Respekti ndaj prindërve është farz apo sunet?

Ky respekt është i detyruar sipas mendimit të gjithë dijetarëve, duke mos pasur kurrfarë dileme mes tyre. Bazuar në argumentet e sakta dijetarët respektin e prindërve e konsiderojnë xhihad në rrugë të Allahut përmes të cilit njeriu e fiton kënaqësinë e Zotit. Ata e vënë këtë respekt para luftës, bile edhe para luftës së bashku me të Dërguarin e Zotit, *sal-lAllahu alejhi ue selem*.

Transmetohet se një djalë i ri shkoi tek Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, dhe kërkoi nga ai leje që ta merrte në xhihad. Profeti e pyeti, se a i kishte prindërit gjallë, kur djaloshi iu përgjigj: Po,- atëherë ai i tha: *“Kthehu te prindërit e tu dhe xhihadi yt është në respektimin e tyre.”* Buhariu: 3004, Muslimi nr. 2549.


Në disa transmetime në fund përmendet fjala: *“Pastaj respektoji të afërmit një nga një, duke filluar nga më i afërti e më larg”*. Pas prindërve kanë të drejtat e tyre edhe të afërmit e tjerë në respekt. Në të futen si prindërit nga ana e babait, ashtu edhe nga ana e nënës, futen fëmijët, nipat e mbesat, vëllezërit e motrat, futen axhët dhe hallat, dajat e tezë. Përparësi i jepet gjyshërve ndaj vëllezërve e motrave, pastaj vëllezër e motra. E të tjerët me radhë. Në çdo kategori ka përparësi njeriu, i cili është më i afërt nga të dyja anët, si nga babai ashtu edhe nga nëna e në radhë të dytë vijnë ata që kanë afërsi vetëm nga njëra anë. Shembull: vëllai nga nëna e babai ka

“...Bazuar në argumentet e sakta dijetarët respektin e prindërve e konsiderojnë xhihad në rrugë të Allahut përmes të cilit njeriu e fiton kënaqësinë e Zotit...”

përparësi ndaj vëllait vetëm nga njëri prind. Disa dijetarë e preferojnë t'i jepet përparësi mirësjelljes ndaj fëmijëve para atyre të gjyshërve, sidomos nëse fëmijët janë të vegjël, kurse gjyshërit akoma të fuqishëm. Allahu e di më së miri.

Në fund dua të përmend, se Islami nuk është diskriminim, por ai është sistem i drejtë, i cili çdo çështje e studion në vetvete të pavarur nga të tjerat. Islami i jep përparësi burrit ndaj gruas, sepse vetëm kjo gjë është e drejtë, ndërsa në këtë çështje nënës i jep përparësi tre fish nënës ndaj babait, e kjo për arsye se vetëm kështu është e drejtë dhe ky është realitet i mbështetur në fakte të qarta e të pamohueshme, prandaj askush nuk ka të drejtë ta akuzojë sistemin e Zotit të zbritur mëshirë për njerëzimin me diçka, e cila është padrejtësi për të, sepse tek e fundit argumentet nuk janë në krah të tij e në anën tjetër nuk mund ta mposhtë këtë fe, por vetëm i bën dëm vetes në këtë botë dhe në botën tjetër. ■

KUSH JAM UNË?



Ndonëse të gjithë jemi të ndërtuar sipas një plani të njëjtë, jemi njëkohësisht krejt të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ka qindra gjëra që të bëjnë ty të ndryshëm nga çdokush tjetër, që nga shija për këngën e ndjenja e humorit deri tek tingulli i zërit e forma e fytyrës.

SHKRUAN: PRIM. DR. MED. SC. ALI F. ILIAZI

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Fisnik urdhëron e thotë: *“Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?”* (Dhariatë, 20-21).

Trupi ynë është një makinë tejet e ndërlikuar. Ka me mijëra vjet që njerëzit përpiqen të kuptojnë si funksionon trupi ynë e megjithatë shumë mistere nuk janë zgjidhur, si p.sh. si punon truri ynë, përse na zë lemza etj. Por një gjë tashmë e dimë me siguri: trupi ynë përbëhet nga ujë, karbon dhe disa elemente të thjeshta

kimike, që mund të gjenden ngado. Në të vërtetë, të gjithë atomet e domosdoshme për ndërtimin e trupit të njeriut mund t'i gjeni në oborrin e shtëpisë suaj. Imagjinoni sikur të ndërtoni nga fillimi një trup njeriu, duke përdorur përbërësit më të thjeshtë të mundshëm. Për këtë do t'ju duheshin vetëm 13 elemente kimike.

1. 65% Oksigjen. Elementi oksigjen zë dy të tretat e trupit tuaj, kryesisht në formën e ujit (H_2O). Ju gjithashtu thithni oksigjen nga ajri sa herë që merrni frymë.

2. 18% Karbon. Pothuajse një e pesta e trupit tuaj është karbon- i njëjti element nga i cili përbëhet qymyri, diamanti dhe grafiti i lapsit. Atomet e karbonit krijojnë

“Imagjinoni sikur dikush të marrë pasaportën tënde, të bëjë operacion plastik, që të duket tamam si ti e më pas të pretendojë se është ti. A mund t’ia dalë mbanë? ...”

zinxhirë të gjatë, duke formuar boshtin e të gjitha molekulave më komplekse brenda jush.

3. 10% Hidrogjen. Hidrogjeni është elementi më i zakonshëm në gjithësi e njëkohësisht ka edhe atomet më të vogla.

4. 3% Azot. Një thes me pleh kimik përmban thuajse të njëjtën sasi azoti, sa një trup mesatar njeriu. Azoti është një nga përbërësit kryesorë të muskujve tuaj. Ai është edhe përbërësi kryesor i ajrit.

5. 1% Fosfor. Ky element bën që të ndizen flakë kunjat e shkrepëseve. Ai gjithashtu forcon dhëmbët dhe kockat tuaja, formon membranat e qelizave dhe ndihmon në transmetimin e energjisë.

6. 0,35% Kalium. Sapuni i tualetit përbëhet nga kaliumi. Kaliumi gjithashtu i mban lëvizjet e trupit tuaj të baraspeshuara kimikisht.

7. 0,15% Klor. Klori është një gaz i gjelbër vdekjeprurës, që përdoret për të prodhuar zbardhuesit. Në trupin e njeriut ai lidhet me natriumin duke formuar kripën e gjellës (klorurin e natriumit).

8. 0,15% Natrium. Natriumi është gjysma tjetër e klorurit të natriumit (kripës). Natriumi i bën lëvizjet e trupit tuaj po aq të kripura sa edhe uji i detit.

9. 0,05% Magnez. Drita e bardhë ndriçuese e fishekzjarrëve vjen nga djegia e magnezit. Në trupin tuaj magnezi forcon

sistemin tuaj imunitar dhe ndihmon në gjallërimin e nervave dhe tkurrjen e muskujve.

10. 0,25% Squfur. Squfuri është një pjesë e zëvendësueshme e proteinave dhe ndihmon në mpiksjen e gjakut. Është gjithashtu shkaktari i erës së keqe të gazrave trupore, vezëve të prishura apo pëllgjeve me ujë të ndenjur.

11. 1,6% Kalcium. Kalciumi është elementi që i bën të forta guaskat e detit, shkumësin dhe mermerin. Ai bën të njëjtën gjë me dhëmbët dhe kockat tuaja dhe gjithashtu mban në punë zemrën dhe muskujt tuaj.

12. 0,008% Hekur. Në gjakun tuaj ka hekur të mjaftueshëm sa për një gozhdë. Hekuri, kur lidhet me oksigjenin bëhet i gjakut dhe kjo është arsyeja pse gjaku dhe ndryshku janë të kuq.

13. 0,00004% Jod. Në trupin tuaj ka më pak se një majë luge jod, megjithatë pa të do të vdisnit. Jepini jod larvave dhe ato kthehen në bretkosa.

Për një trup të përkryer ju nevojitet gjithashtu një sasi e vogël bakri, zinku, mangani, kobalti, litiumi, stronciumi, alumini, silici, plumbi dhe arseniku. Një trup mesatar përmban edhe rreth 90 miligram uran. Trupin e njeriut nuk do të mund ta ndërtoni kurrë vetëm duke përzier elementet kimike. Kjo do të ishte njësoj si të prisje një stuhi në një fushë mbeturinash të ndërtonte një avion reaktiv. Për ta bërë këtë duhet të filloni të punoni me blloqe ndërtimi të përshtatshme. Blloqet më të vogla të ndërtimit janë njësi mikroskopike të quajtura qeliza, por do t’ju duhet të grumbulloni rreth 100 trilion të tilla dhe t’i rregulloni ato sipas një skeme pafundësisht të ndërlikuar.

Thuajse gjysma e qelizave tuaja janë qeliza gjaku. Qelizat e kuqe të gjakut shpërndajnë oksigjenin nëpër trup, duke ju

mbajtur gjallë. Në çdo sekondë ju prodhoni 2 milion qeliza të reja.

Qelizat nervore janë telat e trupit. Sinjalet elektrike shpërndahen nëpërmjet tyre me një shpejtësi prej qindra kilometra në orë. Truri juaj përmban 100 miliardë qeliza nervore. Ju mund të kontrolloni me vetëdije 640 muskuj, por ka qindra muskuj të tjerë, që nuk mund t'i lëvizni në mënyrë të vullnetshme. Rreth 40% e peshës suaj trupore është muskul.

Sistemi nervor lejon që trupi juaj të reagojë ndaj botës me shpejtësinë e vetëtimës. Ai punon si një rrjet me tela dhe kablllo elektrike, vetëm se përçon informacione jo energji elektrike. Qendra tije kontrollit është truri, i cili merr sinjalet nga organet shqisore, përpunon informacionin dhe dërgon sinjale të reja, që i tregojnë trupit si duhet të reagojë. Sinjalet i përshkojnë nervat me shpejtësi 400 km/h.

Të gjitha qelizat e trupit tuaj kanë nevojë të furnizohen me gazin jetëdhënës, oksigjenin, i cili merret nga ajri. Sistemi juaj i frymëmarrjes thith oksigjenin dhe e kalon në gjoks. Organet kryesore të këtij sistemi janë mushkëritë, të cilat thithin ajër, sa herë që marrim frymë. Ato punojnë si sfungjerë gjigantë, vetëm se thithin ajër dhe jo ujë. Ju merrni dhe nxirrni frymë 23.000 herë në ditë. Rrugët ajrore përfundojnë në qeska ajri të quajtura alveola. Këto përkohën nga enë gjaku, që përthithin oksigjenin dhe nxjerrin jashtë dyoksidin e karbonit. Mushkëritë tuaja kanë rreth 600 milionë alveola - nëse do t'i shtrinit ato në një sipërfaqe të sheshtë do të mund të mbuloni me to një fushë tenisi.

Zëri juaj del nga një dhomë e quajtur kutia e zërit (laringu), që gjendet në krye të trakesë. Kur e nxirrni ajrin, ai kalon nëpërmjet dy kordave të vogla. Kur bashkohen, ato dridhen dhe lëshojnë tinguj. Sa më shumë tendosen, aq më i lartë

“...Persona që quhen grafologë, pretendojnë se janë në gjendje të përcaktojnë personalitetin e dikujt vetëm nga mënyra si shkruan ai...”

është zëri. Përkujtojmë këtu ajetin e Kuranit Fisnik: **“Mëshiruesi (Zoti ynë). Ai ia mësoi Kuranin. E krijoi njeriun. Ja mësoi atij të folurit (të shprehurit, të shqiptuarit).”** (Rahman, 1-4).

Ndonëse të gjithë jemi të ndërtuar sipas një plani të njëjtë, jemi njëkohësisht krejt të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ka qindra gjëra që të bëjnë ty të ndryshëm nga çdokush tjetër, që nga shija për këngën e ndjenja e humorit deri tek tingulli i zërit e forma e fytyrës.

Si ndodh që je kaq ndryshe? Përgjigjen e gjejmë pjesërisht tek gjenet e tua. Prindërit tuaj do të duhej të bënin edhe 1.000.000.000.000 fëmijë të tjerë, që të mund të kishin një fëmijë tjetër me të njëjtat gjene si ti. Pjesa tjetër e përgjigjes qëndron tek përvojat që formojnë personalitetin tënd gjatë rritjes. Përkujtojmë duke medituar ajetin e Kuranit Famëmadh: **“Madhëroje larg të metave Zotin tënd, më të lartësuarin! I cili krijoi dhe përsosi dhe i cili përcaktoi e orientoi.”** (El-A'ëla, 1-3).

TË VEÇANTA VETËM PËR TY

Imagjinoni sikur dikush të marrë pasaportën tënde, të bëjë operacion plastik, që të duket tamam si ti e më pas të pretendojë se është ti. A mund t'ia dalë mbanë? Për fat ka shumë mënyra që mund të provojnë vërtetësinë tuaj dhe ato bazohen në faktin se çdokush është biologjikisht i veçantë. Disa nga këto teste

janë aq të efektshme, sa mund të përdoren nga policia për kapjen e kriminelëve, duke u nisur nga gjurmët e vogla të lëna në skenën e krimit. Këto shenja janë:

1. Gjurmët e gishtërinjve- të cilat janë të papërsëritshme. Ato janë të ndryshme edhe te binjakët identikë. Shenjat e gishtërinjve mbeten të njëjta për të gjithë jetën. Edhe kur dëmtohet lëkura, mbasi shërohet, shenjat e gishtërinjve janë njëloj si më parë. Përkujtojmë ajetin kuranor: **“A mendon njeriu se nuk do t’i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t’ia tubojmë! Duke qenë se ne jemi të zotët t’ia rikrijojmë si kanë qenë edhe majat e gishtave të tij!”** (Kijame, 3-4).

2. Irisi- pjesa e ngjyrosur e syve, është po aq e veçantë sa dhe shenjat e gishtërinjve. Çdo iris ka një konfigurim të ndërlikuar vizash dhe hapësirash, që skaneri i syve i lexon, duke i përkthyer në një kod me vija. Megjithatë skanimi i irisit nuk është i përkryer. Kur sëmureni irisit ndryshon dhe duke vendosur lente kontakti mund ta fshihni identitetin tuaj.

3. Sistemi imunitar- rruazat e bardha të gjakut dallojnë qelizat e tua nga ato të njerëzve të tjerë. Nëse në trupin tuaj hyjnë qeliza të huaja (si mikrobet), rruazat e bardha të gjakut i zbulojnë ato dhe i sulmojnë. Fatkeqësisht, ky sistem punon aq mirë sa trupi juaj përpiket të flakë organet e një personi tjetër të transplantuar te ju.

4. ADN- një mënyrë e mirë për të pranuar se cili je është marrja e gjurmës së ADN-së suaj, fragmentohet dhe pastaj këto shtrihen në një shtresë xhelatine duke dhënë një kombinim shiritash. Policia e përdor ADN-në për të gjetur identitetin e njerëzve duke u nisur nga gjaku, fijet e flokut apo indet e tjera të trupit të gjetura në skenën e krimit. Sipas disa ekspertëve mundësitë që dy njerëz të kenë ADN të njëjtë janë 1 në 5.000 miliard miliarda njerëz.

Duke medituar përkujtojmë ajetin kuranor: **“Qoftë mallkuar, njeriu, sa mohues i fortë është ai! Po prej çkafi e krijoi Ai atë? Atë e krijoi prej një pikë uji dhe e përgatiti.”** (Abese, 17-19).

5. Zëri- ndonëse zëri juaj ndryshon sipas humorit, fjalëve që përdorni dhe moshës, ka disa tone të veçanta që mbeten të dallueshëm përjetë. Një analizues i gjurmës së zërit mund t’i nxjerrë dhe t’i dallojë këta tinguj, edhe kur ju flisni në telefon. Disa banka të mëdha përdorin dalluesin e zërit për të kontrolluar identitetin e stafit të tyre. Analizuesit e zërit e kthejnë zërin e njeriut në një konfigurim vijash në kompjuter.

6. Nënshkrimi- çdo njeri ka shkrim dore të dallueshëm nga të tjerët dhe persona që quhen grafologë, pretendojnë se janë në gjendje të përcaktojnë personalitetin e dikujt vetëm nga mënyra si shkruan ai. Mënyra tradicionale për të provuar identitetin tuaj është hedhja e firmës. Firma shkruhet me një veprim të shpejtë, duke e ekzagjeruar ca stilin tuaj të shkrimit, në mënyrë të tillë që e bën firmën apo nënshkrimin të vështirë për t’u kopjuar.

Çfarë është një gjen?

Fjala gjen ka shumë kuptime, por në thelb gjeni është një udhëzim, që i jepet trupit tuaj për mënyrën e funksionimit. Udhëzimi ruhet si një kod në molekulën e ADN-së. ADN-ja është një molekulë shumë e gjatë, por edhe shumë e hollë. Ajo ka formën e një shkalle të përdredhur, këmbët e secilës ndërrojnë një kod të thjeshtë vetëm me katër shkronja A, C, G dhe T (shkronjat përfaqësojnë lëndët kimike). Një gjen është një segment i ADN-së me një renditje të shkronjave, si paragrafi në një libër. ADN-ja juaj duhet të hyjë në një hapësirë shumë të ngushtë, kështu që ajo paketohet në mënyrë gjeniale. Çdo molekulë ADN-je përdridhet përsëri për të

formuar një kordon dhe kështu me radhë (ashtu siç përdridhen fijet e holla për të bërë litarin). Rezultati përfundimtar është një strukturë në formë X-i, që quhet kromozom. Kromozomet janë shumë të vogla për t'u dalluar me sy. Duhet 100.000 kromozome për të arritur në madhësinë e pikës. Megjithatë çdo kromozom ka një ADN dy metra të gjatë.

Çdo qelizë e trupit tuaj (me pak përjashtim) përmban 46 kromozome të ngjeshura së bashku brenda bërthamës së qelizës. Po ta çmbështillnit të gjithë ADN-në nga çdo kromozom i çdo qelize dhe t'i shtrinit molekulat njëra pas tjetrës, ADN-ja do të bënte rrugën Tokë-Diell e kthim 400 herë. Megjithatë informacioni i gjeneve tuaja mund të ruhet në një disk të vetëm.

ADN-ja në një komplet kromozomesh përbën gjenomin tuaj. Ka vetëm 30.000 gjene funksionuese në gjenomin e njeriut. Gjenomi njerëzor është shumë i ngjashëm me atë të specieve të tjera, edhe të bananeve (50%).

Shumë nga karakteristikat tuaja, mbase të gjitha angazhojnë shumë gjene, të cilat veprojnë së bashku. Gjatësia juaj, pamja, lëkura, tingulli i zërit, ngjyra e flokëve e kështu me radhë, ka gjasa që varen nga kombinimi i gjeneve që keni. Ndjesia e të qenit i ndërgjegjshëm e që përjetohej kur je zgjuar, quhet vetëdije.

Vetëdija përfshin të gjitha informacionet që japin shqisat dhe mbizotërohet nga shikimi- shqisa juaj kryesore. Ajo përfshin edhe botën tuaj të brendshme tek e cila mbyllet dhe askush nuk mund të futet. Mendimet, idetë, ndjenjat, ëndërimi kur jeni zgjuar dhe imagjinata juaj janë të gjitha pjesë të vetëdijes.

Të gjithë kemi ndjesinë sikur kemi një person brenda trurit tonë. Ky person i brendshëm është vetja jote- ajo e vërteta. Ai

ka mendimet e tua, e sheh botën me sytë e tu dhe zhduket kur shkoni të flini.

Ëndrrat me sy hapur në mënyrë të pakontrolluar, por ju edhe mund t'i përqendroni mendimet tuaja dhe t'i kontrolloni imazhet në mendjen tuaj. Kjo ndodh kur përdorni imagjinatën tuaj. Mendimet ndonjëherë marrin formën e zërit të brendshëm dhe jo të imazheve apo ndjenjave. Përjetimi i botës është tërësisht personal. Asnjë nuk mund të përjetojë mendimet dhe ndjenjat e tua. Prandaj mesazhi i Kuranit Fisnik është i përhershëm, për çdo kohë dhe për çdo brez: ***“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona, në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kurani) është i vërtetë.”*** (Fusilet, 53).

Çfarë njeriu jam unë? Cili është potenciali im? Cilat janë aftësitë tuaja?

-Ndërpersonale- A e kuptoni shpejt se çfarë mendojnë dhe ndjejnë të tjerët?

-Vetëpersonale- A i kuptoni siç duhet ndjenjat dhe emocionet tuaja- a e njihni veten tuaj?

-Fizike- A i mësoni shpejt shprehitë fizike, si ngasja e makinës, skitë, sportet etj.

-Muzikore- A mund ta këndonit melodinë e një kënge pasi ta keni dëgjuar një herë dhe a e këndonit saktë atë?

-Hapësinore- A mund t'i lexoni me lehtësi hartat?

-Gjuhësore- A jeni lexues i pangopur ose i zoti në të shkruar?

-Logjike- A ju duken të lehta për t'u kuptuar lëndë të tilla si matematika apo kompjuteri?

Sekreti i suksesit tuaj është të njihni **AFTËSITË** tuaja më të mira e t'i përdorni ato! ■

MËSIME TË RËNDËSISHME RRETH FAREFISNISË DHE BOJKOTIT

ZGJODHI DHE PËRKTHEU: NEXHAT CEKA

Pyetje: Daja im i tha nënës sime prej sot nuk dua t'ju shoh asnjëherë. Çfarë mund të bëjmë ne në këtë rast, duke pasur parasysh se ne nuk i kemi bërë diçka që ta nervozojmë atë apo familjen e tij.



Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

Përgjigja: Falënderimi i takon Allahut. Patjetër duhet të kërkohet shkaku, se pse ka ndodhur hidhërimi, ngaqë nuk mund të paramendohet të ndodh një rast i këtillë pa kurrfarë shkak, dhe ndoshta ju nuk e dini, prandaj po qe se nuk jeni ju shkas për ta hidhëruar personin në fjalë, atëherë ju nuk keni kurrfarë përgjegjësie për hidhërimin e tij, mirëpo ju bëni sabër, si dhe silluni mirë me të, edhe pse ai është sjellë keq me ju, se ndoshta kjo mund ta çojë atë të pendohet, kur të shohë sjelljen e mirë nga ju. Shpesh këto qëndrime bojkoti të ashpra, të afatizuara vijnë si rezultat i hidhërimit të temperamentit personal të njeriut nga vetë ai, mirëpo kur pas një kohe qetësohet prapë kthehen punët si kanë qenë më parë. Ndonjëherë mund të ndodhin raste të vështira, të cilat janë në pajtim me tabiatin e keq shpirtëror, urrejtjen, konfliktin fisnor me plot urrejtje, prej kësaj rrjedh këputja e lidhjeve farefisnore të përhershme, prandaj në zgjidhjen e kësaj çështje duhet të punohet gradualisht, duke i përkujtuar të dyja palët për rrezikun e shkëputjes së lidhjeve farefisnore, po ashtu këshillohen me fjalë të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, të cilat i qortojnë ashpër shkëputjen e lidhjeve farefisnore. Në të njëjtën kohë po qe se njëerës anë i është bërë padrejtësi duhet t'i kthehet haku, duke u munduar t'i jepet përparësi atij që i është bërë padrejtësi, si dhe duke u munduar t'i pajtojnë palët sa të jetë mundësia siç thotë Allahu: ***“Pajtoni njëri-tjetrin”***, ndërsa ai i cili e merr këtë përgjegjësi shpreson në shpërblimin e Allahut, që ceket në fjalën e Allahut: ***“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do ti japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh”***. (Nisa, 114).

Ndonjëherë është më mirë të mos ndërhysh menjëherë për t'i pajtuar, kjo ngase më mirë është të presësh derisa të qetësohet gjendja, të ulet tensioni i hidhërimit ndërmjet palëve, që pastaj të merret iniciativa për pajtim. Allahun e lusim të na udhëzojë të gjithëve.

Shejh Muhamed Salih El-Munexhid.

Pyetja: Kam një vajze mixhe, të cilën nuk e vizitoj sepse më dëmton, mirëpo përskaaj kësaj unë i jap selam asaj në takimet familjare apo në dasma, vallë me këtë gjest a llogaritet se i mbaj lidhjet farefisnore? Si dhe a llogaritet ajo prej farefisit?

Përgjigja: Falënderimi i takon Allahut.

Një: Atë që e potencove se ti i jep vetëm selam, kur e takon e jo diçka tjetër, kjo mjafton për njerëzit e prishur, si lidhje farefisnore për ta, Allahu na faltë.

Dy: Vajza e mixhës tënde hyn në përgjithësi në farefisninë më të gjerë, të cilët duhet t'i mbash lidhjet dhe të sillesh mirë me ta, po ashtu t'u tregosh dashuri atyre, mirëpo a thua vallë janë nga farefisi, i cili është detyrim të mbahen lidhjet me ta, ka mendime të ndryshme të dijetarëve? Sqarim i kësaj çështje është se: farefisi është dy llojesh: farefis i ngushtë (mahrem) dhe farefis më i gjerë.

Farefis i ngushtë (mahrem) llogaritet çdo dy persona, që e kanë të ndaluar të martohen me njëri-tjetrin, qoftë mashkull apo femër, të cilët nuk e kanë të lejuar të martohen me njëri-tjetrin, si prindërit, nëna, motrat, vëllezërit, gjyshi, gjyshja, e më lart tyre, si dhe fëmijët e tyre, xhaxhallarët, hallat, dajallarët dhe tezet. Ndërsa fëmijët e xhaxhallarëve, dajallarëve, hallave, tezeve, nuk janë nga farefisi i ngushtë, sepse lejohet të martohemi me to.

Ndërsa **farefisni e gjerë** llogaritet: kushdo përveç farefisit të ngushtë, si për shembull vajza e xhaxhait, vajza e hallës, djali i xhaxhait, djali hallës, djali i dajës e

kështu me radhë.

Disa dijetarë kanë thënë se e kemi detyrim t'i mbajmë lidhjet farefisnore me fisin e ngushtë, ndërsa farefisi jo i ngushtë është e pëlqyeshme të mbahen lidhjet farefisnore me të, por nuk është detyrim. Ky mendim është i Hanefive, Mendim më pak i njohur tek Malikitë, si dhe Mendim Ebul Hatabit nga Hanbelitë. Argument i këtyre është se sikur të ishte detyrim mbajtja e lidhjeve farefisnore e të gjithë të afërmeve, atëherë do të detyroheshim t'i mbajmë lidhjet me të gjithë bijtë e Ademit, dhe një gjë e tillë është e pamundshme, prandaj është e patjetërsueshme, që të përkufizohet me mbajtjen e lidhjeve farefisnore me farefisnin më të ngushtë, si dhe e kemi të ndaluar bojkotin e tyre, e ata janë të afërmit sipas gjakut.

Mendimi **i dytë** në këtë çështje është se: detyrohem t'i mbajmë lidhjet farefisnore me të gjithë, pa marrë parasysh, a janë familje e ngushtë apo jo. Ky është një mendim tjetër i njohur tek Hanefitë në këtë çështje, mendim i njohur tek Malikitë, mendimi tekstual i Ahmedit, po ashtu një gjë e tillë kuptohet prej fjalëve të Shafive në përgjithësi, asnjëri prej tyre nuk i ka kufizuar lidhjet farefisnore me anën e gjakut. (El Meusuatu el fikhie el kuvejtie 3/83). Shih: Gidhau el bab, të Sifariniut 1/354, Berikatu mahmudie 4/153).

Autori i librit Subulu Selam 2/628 thotë: Dije se dijetarët kanë mendime të ndryshme, në lidhje me atë se si përkufizohet farefisi dhe me kë e kemi për detyrim që t'i mbajmë lidhjet me të: Është thënë se farefis llogaritet kushdo, të cilin e ke të ndaluar të martohesh me të, qoftë mashkull apo femër. Kështu që këtu nuk hyjnë fëmijët e xhaxhallarëve e as të dajallarëve. Këta janë argumentuar me faktin, se është e ndaluar që një grua të bëhet shemër me hallën e saj apo tezen e saj,

sepse një nikah i tillë çon deri tek bojkoti.

Disa kanë thënë: Këtu hyn çdokush që ka lidhje me trashëgiminë, argument për këtë është fjala e Pejgamberit *alejhi salatu ue selam*: "*Pastaj ata që janë më poshtë, pastaj të tjerët më të afërt*".

Disa kanë thënë: Kushdo që ka lidhje fisnore pa marrë parasysh a trashëgon apo jo.

Kadi Ajadi thotë: se mbajtja e lidhjeve farefisnore është shkallë-shkallë, disa janë më lart se disa të tjerë. Lidhja më e ulët është mosbojkotimi i tyre, përsëendetja e tyre me selam dhe të folurit me ta. Kjo varet krejt nga mundësia dhe nevoja, diçka prej saj është detyrim e diçka e pëlqyeshme, prandaj po qe se i mban disa lidhje dhe nuk mund t'i mbash disa të tjera në maksimum ky njeri nuk llogaritet se nuk i mban lidhjet farefisnore, ndërsa po qe se është i shkujdesur në disa raste kur ka mundësi, ky person nuk llogaritet se i mban lidhjet farefisnore.

Kurtubiu thotë: "Farefisi që duhet të mbahet është dy lloje: i përgjithshëm dhe i përveçëm, i përgjithshëm është: mbajtja e lidhjeve me çdo musliman në përgjithësi, duke i dashur muslimanët, duke i këshilluar ata, duke qenë i drejtë me ta, si dhe duke i çuar në vend detyrat që ka çdo musliman ndaj muslimanit. Ndërsa i përveçëm ka një gjë më tepër, se për të duhet të kujdesesh për gjendjen e tyre, që të mos i harrosh ata".

Prandaj pa marrë parasysh vajzë mixhe, a është detyrim për t'i mbajtur lidhjet me ta apo jo, apo llogaritet që e ke familje, ku është e pëlqyeshme mbajtja e lidhjeve me te, në qoftë se të bën dëm po qe se përzihesh me te apo e viziton, atëherë të mjafton vetëm t'i japësh selam dhe t'i flasësh kur ta takosh në ndonjë rast, dhe në këtë rast kjo nuk të llogaritet se i ke shkëputur lidhjet farefisnore me të. Allahu e di më së miri. ■

Muhamed Salih el Munexhid

Pyetje: A më lejohet mua t'i ndërpres lidhjet farefisnore me të afërmit e mi, për shkak se merren me kamatë, u shesin tokat jahudive, si dhe ushqehen me haram? Po ashtu a më lejohet mua t'i jap selam atyre?

Përgjigja: Falënderimi i takon Allahut.

Një: Allahu e ka bërë detyrim të mbahen lidhjet familjare dhe e ka ndaluar shkëputjen e tyre. Allahu thotë: ***“Adhurojeni Allahun, mos i bëni shirk atij diçka, me prindërit silluni mirë dhe me farefisn tuaj.”*** (Nisa: 36), po ashtu thotë: ***“Jepini hakun të afërmve tuaj, të ngratëve, si dhe kalimtarëve që kanë ngelur në rrugë.”*** (Rum: 38), po ashtu thotë: ***“Kini frikë Allahun, mbani lidhjet farefisnore për të cilat do të pyeteni, sepse Allahu është Mbikëqyrësi i juaj.”*** (Nisa : 1).

Ajetet dhe hadithet në këtë kontekst janë të shumta, të cilat e detyrojnë mbajtjen e lidhjeve farefisnore dhe ndalojnë nga këputja e tyre, po ashtu Allahu e mallkon atë që i këput lidhjet farefisnore. Allahu thotë: ***“A nuk pritët prej jush (hipokritëve), që nëse merrni sundimin (ose zmbarseni prej Fesë Islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpriten lidhjet e akraballëkut? Janë ata që Allahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua verboi shikimin e tyre”.*** (Muhamed, 22-23). Prandaj shkëputja e lidhjeve farefisnore llogaritet prej mëkateve të mëdha pa kurrfarë diskutimi.

Dy: Mosfolja ndaj muslimanit është dy llojesh, ose për dynja si për nxënien e fëmijëve, ose për çështje fetare, si rasti i dikujt që bie në bidate apo bën mëkate. Prandaj po qe se hidhërohet me dikë për ndonjë çështje të kësaj bote nuk lejohet të rrijë i hidhëruar më shumë se tre ditë, edhe pse hidhërimi është i ndaluar në thelb, mirëpo po qe se hidhërohet për ndonjë çështje të shariatit, atëherë i lejohet të rrijë i hidhëruar më shumë se tri ditë, derisa ai person të largohet nga ai bidat, ose të

pendohet nga ai mëkat.

Mirëpo mund të ndodhë që mosfolja jote ndaj atij që bie në bidat apo mëkat të bëhet shkak që ai të vazhdojë më keq në bidatin apo mëkatin e tij, atëherë me këtë bojkot nuk është arritur qëllimi i bojkotit; në këtë rast nuk lejohet mosfolja, ngase Sheriati e ka lejuar distancimin në këtë kontekst: nga shkak që të vijë deri tek përmirësimi i personit në fjalë me këtë bojkot, ndërsa po qe se nuk ka përmirësim, atëherë nuk është e lejuar bojkoti. Kështu në këtë rast kërkohet ndonjë metodë më e përshtatshme për ta përmirësuar këtë njeri si: nxitja e tij me fjalë të buta dhe me inkurajimin, që të largohet nga e keqja, e kështu me radhë.

Shejhul islam Ibën Tejmije thotë: “Sa i përket bojkotit që iu bëri Pejgamberi *alejhi salatu ue selam* atyre tre personave që u vonuan në luftë, si dhe bojkoti i Omerit dhe i muslimanëve ndaj atij që lyhet me bojë, ky është një lloj dënimi, prandaj po qe se me këtë bojkot arrihet qëllimi që të përmirësohet i keqi dhe të kthehet në rrugën e drejtë, atëherë ky bojkot është i vlefshëm, ndërsa po qe se me të arrihet në shkallën e rritjes së fesadit dhe mëkatit, atëherë nuk është i vlefshëm bojkoti.” (Mexhmua-fetava, 28\216-217).

Shejh Abdulaziz ibën Bazi është pyetur, se çfarë qëndrimi duhet të kemi ndaj mëkatarëve të mëdhenj: ai thotë: “Kush bën mëkate të mëdha duhet të këshillohet, si dhe t'i tërhiqet vërejtja nga rreziku i keq i përfundimit të këtyre veprave, dhe se mëkatet e ngurtësojnë zemrën dhe e forcojnë atë, dhe e vdesin. Ndërsa ai që bën mëkate haptazi: ky person duhet të ekzekutohet për atë mëkat, të paraqitet tek prijësi i muslimanëve dhe nuk lejohet që ky njeri të shoqërohet, bile këta tipa duhet të bojkotohen ndoshta Allahu mund t'i udhëzojë, përpos nëse bojkoti realizon që ai të bëhet edhe më i keq, atëherë në këtë rast

e këshillon me metoda më të mira dhe efikase, ndoshta Allahu e bën që të pendohet dhe të udhëzohet, ndërkaq këta persona nuk merren prapë si shokë, mirëpo këshillohen kohë pas kohe.” (Fetava islamije 4\520).

Shejh Muhamed ibën Salih Utthejmini thotë: “Në qoftë se bojkoti bën dobi ose e largon të keqen, e cila do të jetë shkas për ndryshimin e të keqit në të mirë, ose e çon mëkatarin të kthehet nga mëkatet, në këtë rast lejohet bojkoti, bile thuajse është i kërkuar, krejt kjo sipas madhësisë së mëkatit.”

Ndërsa sot po shohim, se bojkoti ndaj disa personave të këqij çon që ata të bëhen edhe më të këqij, duke vazhduar në mëkate me inat, kështu që largohen nga dijetarët dhe besimtarët, kështu që nga ky bojkot nuk ka kurrfarë dobie, as për ta, as për të tjerët. Bazuar në këtë themi: Bojkoti është ilaç, i cili përdoret ku bën mirë, ndërsa ku nuk shërben për shërim, atëherë nuk përdoret.

Bojkoti është tri llojesh: Kur dobia rëndon atëherë ai kërkohet. Kur dëmi është i sigurt, atëherë ndalohemi nga bojkoti. Kur nuk rëndon, as dëmi, as dobia, atëherë më afër është ndalesa nga kjo vepër; bazuar në hadithin e përgjithshëm, ku qëndron: “*Nuk i lejohet muslimanit ta bojkotojë, mos t'i flasë vëllait të tij më shumë se tri ditë*”. (Mexhmua fetava Ibën Utthejmin, Pyetja Nr: 385).

Shejh El-Feuzani thotë: “Bojkoti ndaj muslimanit nuk lejohet më shumë se tri ditë për ndonjë çështje të dynjasë, prandaj kur ta takojë vëllanë e tij pas kësaj kohe duhet të pajtohet dhe t'i japë salam kur ta takojë, edhe pse bojkoti për çështjet e dynjasë nuk është i mirë që në esencë të vet, mirëpo po qe se ndodh bojkoti nuk duhet të zgjatet më shumë se tre ditë, ngase ky është kuptimi i hadithit: “*Nuk i lejohet muslimanit ta bojkotojë, mos t'i flasë vëllait të tij më*

shumë se tri ditë”. Pra, ka si qëllim kur bojkoti bëhet për ndonjë çështje nga çështjet e dynjasë.

Ndërsa po qe se bojkotohet mëkatarin për shkak të mëkatit që ai bën, duke qenë mëkati prej mëkateve të mëdha, dhe ky person nuk largohet nga ai mëkat: atëherë në këtë rast detyrohem ta këshillojmë të ketë frikë Allahun, e në qoftë se vazhdon prapë e nuk ndalet nga mëkati, atëherë bojkotohet. Ndoshta bojkoti e çon të pendohet; përpos po qe se bojkoti çon deri tek dëmi më i madh; atëherë nuk lejohet të bojkotohet, prandaj bojkoti është i vlefshëm, kur ka dobi dhe nuk çon në një dëm më të madh”. (El-munteka min fetava Shejh El-Feuzan, 1\273-274).

Tre: Dispozita e dhënies selam bidatçiut, apo mëkatarit, është e njëjtë me atë të bojkotit, pra çështja sillet rreth asaj, se a përfiton i bojkotuari me këtë gjest apo jo. Në qoftë se bojkoti çon tek e mira, atëherë nuk i jep selam, ndërsa po qe se bojkoti nuk bën dobi, atëherë i jep selam. Shejh Muhamed ibën Salih Utthejmini thotë: “Bojkoti po qe se i bën dobi mëkatarit, atëherë bojkotoje, përndryshe mos e bojkoto. Në qoftë se takon një person që pi duhanin, dihet se pirja e duhanit është mëkat, prandaj pirja e duhanit haptazi e zbret personin në atë gjendje që nuk i pranohet dëshmia, prandaj jepi selam këtij njeriu kur e sheh se bojkoti nuk bën dobi. Jepi selam, se ndoshta kur i jep selam mund të bisedosh me të dhe t'i tregosh se duhani është haram. Ta këshillosh se një gjë e tillë nuk është mirë ta bësh, e ndoshta e shuan cigaren dhe e le. Ndërsa po qe se nuk i jep selam, të merr inat dhe nuk e pranon këshillën nga ti, edhe në qoftë se bën mëkate haptazi: jepi selam dhe këshilloje”.

(Likaul-meftuh, 165 pyetja Nr: 8).

NJERËZ ME NDIKIM

Në qoftë se preferojmë për veten tonë që të ndjekim mësimet e tyre, atëherë duhet që të përfitojmë edhe nga devotshmëria e tyre, nga morali, sinqeriteti, bujaria etj

SHKRUAN: ENIS RAMA

Njerëzit si krijesa të Allahut dallojnë në shumë aspekte ndërmjet tyre. Krahas dallimeve të mëdha në dukjet, gjuhët, shijet dhe të ngjashme me to, ata dallojnë edhe më tepër në ambiciet dhe vullnetet e tyre. Disa nga ata mjaftohen me një jetë tejet modeste pa shënuar ndonjë arritje të theksuar, ndërsa disa të tjerë nuk ndalen derisa të prekin majat e suksesit të synuar.

Në bazë të këtyre dallimeve ata ndahen në pasues dhe të pasuar, në udhëheqës dhe të udhëhequr. Prandaj çdo popull i ka të preferuarit e tij, që shërbejnë si shëmbëlltyra dhe u referohen mësimave të tyre për tërë atë që kanë nevojë në jetën e tyre. Tek ne muslimanët, padyshim se të dërguarit e Allahut zënë vendin kryesor në këtë drejtim. Allahu i Madhëruar i zgjodhi, që ata të jenë shembull për njerëzit dhe përmes mësimave dhe udhëzimeve të tyre të ndikojnë në jetën e njerëzve në përgjithësi. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, prandaj edhe ti ndiq rrugën e tyre.”*** Enam-90. Ndërsa për të Dërguarin tonë thotë: ***“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”*** Ahzab-21. Nga kjo na bëhet e qartë, se të dërguarit e Allahut në përgjithësi janë mësuesit e njerëzimit dhe janë shembuj për ta. Në krye të tyre është i Dërguari ynë



Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue sel-lem*, i cili ka qenë dhe do të mbetet shembulli i pazëvendësueshëm për tërë njerëzimin deri në ditën e fundit të kësaj bote.

I Dërguari *sal-lallahu alejhi ue sel-lem* la pas vete një trashëgimi të madhe të fjalëve dhe veprave, që na mbetet neve t'i ndjekim ato mësimet dhe t'i vejmë në praktikë ato që na janë e kërkuar. Mirëpo duke pasur parasysh se jo të gjithë nga muslimanët do të kenë mundësi të kenë qasje në këtë trashëgimi dhe do të kenë ambicie për t'u marrë me studimin dhe shtjellimin e kësaj trashëgimie, atëherë i Dërguari *sal-lallahu alejhi ue sel-lem* veçoi një kategori të posaçme njerëzish e për të cilët na thotë: *"Dijetarët janë trashëgimtarët e të dërguarve."*

Dijetarët tanë me përkushtimin më të madh iu qasën kësaj trashëgimie dhe e përcollën në mënyrën më dinjitoze, duke u shndërruar kështu në shembuj të gjallë dhe praktikë të atyre që do t'i mbrojnë vlerat dhe do t'i luftojnë të gjitha ato dukuri negative, që rrezikojnë shoqërinë në përgjithësi.

Dijetarë tanë në dallim nga të tjerët, nuk ishin dhe nuk mbetën vetëm burime informacionesh, duke bërë kështu një ndarje të dhunshme mes asaj që flitet dhe veprohet, por u kthyen në shembuj devotshmërie, morali, sinqeriteti e shumë të tjera, të cilat para se t'ua mësonin të tjerëve me fjalë ua mësonin përmes veprave të tyre.

Tek të tjerët mund të gjejmë, që një i dijshtëm i tyre, që ua mësoi njerëzimit shumë gjëra të dobishme të ketë qenë në anën tjetër i thyer shpirtërisht, plot depresione e shqetësime. Ka pasur të atillë që preferuan për veten e tyre, që përmes vetëvrasjes t'i japin fund jetës së tyre e shumë anomali të ndryshme, që i lexojmë për të tillë dijetarë, të cilët fatkeqësisht nuk arritën që përmes dijes që patën ta ndriçojnë zemrën e tyre dhe t'i garantojnë vetes së tyre një jetë më të lumtur. Prandaj ne me plot mburrje dhe

“Dijetarë tanë në dallim nga të tjerët, nuk ishin dhe nuk mbetën vetëm burime informacionesh, duke bërë kështu një ndarje të dhunshme mes asaj që flitet dhe veprohet...”

krenari flasim për dijetarët tanë, sikurse Ebu Hanifeja, Maliku, Shafiu, Ahmed, Sufjani, Evzaiu etj. Krahas asaj që ishin shembuj të diturisë ata njëherësh ishin edhe shembuj devotshmërie, sinqeriteti, bujarie, guximi, solidariteti, morali etj. Ne si muslimanë kur flasim për ta dhe trajtojmë biografite e tyre duhet që pos dijes që marrim nga ata dhe me kënaqësi ndjekim mësimet e tyre, të marrim nga ata edhe ndikimin e këtyre mësimave në jetën e tyre të përditshme.

Një qasje selektive ndaj trashëgimisë që lanë na bën të mangët dhe na privon edhe nga përfitimi real edhe i vetë diturisë që marrim nga ata. Në qoftë se preferojmë për veten tonë që të ndjekim mësimet e tyre, atëherë duhet që të përfitojmë edhe nga devotshmëria e tyre, nga morali, sinqeriteti, bujaria etj. Në këtë mënyrë do të kemi mundësi që të përfitojmë nga ata dhe nëse eventualisht takohemi tek ndonjë mospajtim mes tyre atëherë kjo do të shërbejë si pasuri e asnjëherë si mundësi për përçarje dhe konflikt. Një trajtim i kompletuar i biografisë së tyre do të na sillte përfitime të ndryshme e që në vijim do të mund të veçonim disa prej tyre:

Dëshmia konkrete se mësimet islame janë të pranueshme për natyrshmërinë e njeriut

Jo rrallëherë dëgjojmë sot zëra të atillë, që e pranojnë se Islami i ka mësimet më të mrekullueshme, më të arsyeshme, por e meta është se njeriu nuk mund t'i vërë në

praktikë ato. Këta dijetarë janë dëshmitarët më të mirë, se njeriu ka mundësi të jetë autoritativ dhe njëkohësisht të jetë i devotshëm dhe i moralshëm.

Ata na mësojnë se kemi mundësi të merremi me dituri, me punë dhe njëherësh edhe t'i përkushtohemi Zotit tonë me adhurime dhe vepra të mira. Nga ajo që ata na lanë bindemi, se është e mundshme që njeriu ta refuzojë atë që i ofrohet nga të mirat materiale, në qoftë se marrja e tyre do të ishte në llogari të parimeve dhe vlerave që i bart njeriu. Të gjitha këto dhe shumë gjëra të tjera këta dijetarë na i dëshmojnë se janë të mundshme dhe të realizueshme.

Përkryerja e veprave

Nga jeta e dijetarëve tanë mund të veçojmë edhe atë, se çdo punë që kanë bërë dhe e bëjnë janë përpjekur, që ta kryejnë në mënyrën më të përkryer. Prandaj nëse shikon në kërkimin e diturisë i gjen në majat e këtij kërkimi me ç'rast ka ndodhur, që në kërkimin e një thënie të të Dërguarit të udhëtojnë me ditë e javë. Nëse shikon në adhurimin e tyre vëren se kanë bërë përpjekjet maksimale, që të jenë të përkushtuar dhe të devotshëm në këtë adhurim. Prandaj nëse i referohemi këtyre shembujve do të kemi mundësi të shtojmë veprat tona dhe të përmirësojmë kualitetin gjatë kryerjes së tyre.

T'i edukojmë fëmijët tanë nën hijen e këtyre shembujve

Të rinjtë tanë sot kanë të preferuarit e tyre dhe duke i pasur ata si shembuj mundohen që si ata të vishen, të sillen, të flasin etj. Fatkeqësia qëndron në atë, se këta shembuj jo vetëm që nuk janë muslimanë, por ata edhe ushtrojnë profesionet më të pafrytshme për shoqërinë. Në mungesë të shembujve të mirëfilltë apo në prezantimin e cunguar të tyre, atëherë muslimanët e gjejnë

veten të detyruar të kërkojnë alternative tjera.

Në prezantimin e mirëfilltë të dijetarëve tanë, si p.sh. në shfrytëzimin e kohës, në leximin dhe studimin e gjatë, në guximin dhe trimërinë e shumë të tjera muslimani i kësaj kohe do të gjendet para një thesari shumë të pasur suksesesh dhe arritjesh me ç'rast nuk do të ketë as nevojën minimale për huazime. Madje këta shembuj do t'ia bëjnë të qartë, se kush i dha me të vërtetë kontribut shkencës dhe njerëzimit në përgjithësi.

Burim i krenarisë dhe inkurajimit

Përmes këtyre shembujve dhe trajtimit të mirëfilltë ku mësojmë për sukseset dhe të arritjet e tyre, na përshkon në vazhdimësi një krenari, se ne si muslimanë kemi qenë gjithnjë ata të cilët promovuan realisht vlerat e lirisë dhe të drejtave. Ne – me ndihmën e Allahut- u treguam njerëzve se si udhëhiqet dhe administrohet me vendin dhe pasurinë. Ua mësuam atyre singjeritetin, devotshmërinë, bujarinë, guximin etj.

Në anën tjetër, tek ata gjejmë se në rrethana shumë më të pavolitshme se ato që ne gjendemi sot dhe me kushte e mundësi shumë më të vogla se sa i kemi ne, megjithatë ia arritën dhe prekën majat e suksesit në të gjitha rrafshet e kësaj bote. Prandaj ky është një inkurajim për ne, që të mbështetemi tek Allahu i Madh dhe pastaj të përdorim atë që kemi për dore për të arritur atje ku është e kërkuar nga ne të arrijmë. Për këto dhe shumë të tjera, na nevojitet një studim më i thelluar dhe më përfshirës i biografive të dijetarëve tanë e që pastaj me lejen e Allahut këto mësimet të na çojnë atje ku çuan edhe vetë ata që i jetësuan në praktikë këto mësimet. ■